



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në “Agjent i Pasurive të
Paluajtshme”**

Kolegji Universitar “ WISDOM”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Asoc. Elida Liko

Dr. Adea Pirdeni MJur (Oxon)

Tetor / 2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për Programin e studimit me karakter profesional në “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”**


1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "WISDOM"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i së Drejtës Private
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në: “ Agjent i Pasurive të Paluajtshme”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 454, datë 25.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	17 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	21 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në bazë të Urdhërit Nr. 454, datë 25 Korrik 2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është hapur pranë Kolegjit Universitar (KU) "Wisdom", programi i studimit me karakter profesional "Agjent i Pasurive të Paluajtshme". Ky program studimi profesional është i organizuar në dy vite akademike me 120 ECTS (me kohë të plotë). Njësia përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e këtij program studimi profesional është Departamenti i së Drejtës Private, i cili është një prej tre njësive përbërëse të Fakultetit të Drejtësisë. Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga: Departamenti i të Drejtës Private, Departamenti i të Drejtës Publike dhe Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Fakulteti i Drejtësisë është një prej dy njësive kryesore përbërëse të KU "Wisdom". KU "Wisdom" përbëhet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Të dy njësitë akademike të këtij institucioni janë në funksion të zhvillimit të programit profesional të studimit "Agjent i Pasurive të Paluajtshme", nëpërmjet stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.

Programi është i organizuar brenda Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Niveli 5) dhe synon të plotësojë kërkesat e tregut përkatës të punës. Përmes këtij programi studimi që ofrohet për herë të parë në Shqipëri, bazuar në formimin teorik dhe praktik, studentët përgatiten për t'u punësuar si agjentë të pasurive të paluajtshme në agjenci imobiliare, në zyrat e shoqërive investuese ose të ndërtimit si dhe në biznese të tjera që manaxhojnë pasuri të paluajtshme.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Kolegji Universitar "WISDOM" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit me karakter profesional në "Agjent i Pasurive të Paluajtshme", nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL. Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, date 11.09.2018, për programin e studimit me karakter profesional në “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga KU “Wisdom”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. As.Dr. Elida Liko dhe Dr Adea Pirdeni. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Vizita 2 ditore në KU “Wisdom”, u realizua gjatë datave 18-19 Qershor, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë ditëve të vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjës të Departamentit dhe Dekanin e FD, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore etj. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Kolegji Universitar “WISDOM”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.09.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 51/25 Prot, datë 11.09.2020. Kolegji Universitar “WISDOM”, përcjell në ASCAL më datë 14 shtator, me anë të shkresës me Nr. 111 Prot, datë 11.09.2020, “Mendimin për draft raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional në “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” përmban element të domosdoshëm teorikë dhe praktikë për të realizuar objektivin e përgatitjes së agjentëve që do të ndërmjetësojnë transaksione me objekt pasurisë e paluajtshme. Ky program studimi dy vjeçar me 120 ECTS (me kohë të plotë dhe në gjuhën shqipe) është organizuar sipas sistemit të Arsimit të Formimit Profesional (<i>nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve</i>), në përputhje me parashikimet e nenit 72 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”.</p> <p>Qëllimi kryesor i këtij programi është, krijimi i një kaste profesionistësh të rinj, të cilët do të shërbejnë, me dijet e tyre, jo vetëm brenda vendit tonë. Bazuar në faktin se ky është i vetmi IAL që ofron program studimi të agjent në pasuri të paluajtshme, do të kontribuojë në:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përshtatje më të mirë të nevojave të tregut të punës dhe aftësive të punë kërkuesve në tregun imobiliar;- Rritje të cilësisë të shërbimit nga agjensitë që operojnë në këtë treg, si pasojë e rritjes së kualifikimit profesional të punonjësve të tyre; <p>Programi i studimit është në përputhje me planin e strategjik të zhvillimit të KU “Wisdom”, për vitet 2018 - 2023. (<i>Aneksin 1.03</i>). Krahas planit strategjik të zhvillimit të institucionit në tërësi, është përgatitur edhe plani strategjik afat mesëm për programin e studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”. (<i>Aneksi 2.9</i>)</p>

	<p>Nga analiza e të dy planeve strategjike, konkludohet se vizioni, misioni dhe objektivat strategjikë të këtij programi studimi janë në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit, si dhe me Statutin e KU “Wisdom”.(Aneksin 1.01)</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Sipas pikës 6 të statutit të KU “Wisdom”, (Aneksi 1.01), përcaktohet se institucioni ka si qëllim të ofrojë edhe veprimtari mësimore e trajnuese profesionale, në përputhje me kartën e Bolonjës dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ofrimi i programeve të studimit me karakter profesional është e përcaktuar edhe në pikën 1, nenin 42 të Rregullores të KU “Wisdom”, (Aneksi 1.02). Këto akte rregullatore të KU “Wisdom” janë të miratura nga autoritetet drejtuese sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional në “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” është një program ndërdisiplinor që ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Private, me qëllim që të plotësohen nevojat e tregut të pasurive të paluajtshme me profesionistë të kualifikuar, në përputhje me pikën nr. 2, neni 42 të Rregullores të KU “Wisdom”.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Në përputhje me nenin 7 të Rregullores së Brendshme, të Departamentit të së Drejtës Private, paraqitur në (Aneksin 2.06), Departamenti, është përgjegjës për programin e studimit që ofron. Programi i profesional i ofruar është në përputhje me drejtimit akademike të Institucionit dhe zbatohet nga dy njësitë kryesore përbërëse të KU “Wisdom”, konkretisht, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Programi profesional synon që studentët të fitojnë aftësi të agjentit të pasurive të paluajtshme, duke ofruar një gërshetim të njohurive ekonomike, të tilla si procesi i vlerësimit, menaxhimit, marketingut të pronave me njohuri juridike të nevojshme për procesin e negocimit, informimit të palëve për detyrimet përkatëse si dhe nënshkrimin e kontratave me objekt pasuri të paluajtshme.</p>
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e</p>	<p>Në Shqipëri nuk ka një kuadër të ligjor që rregullon profesionin e agjentit të pasurive të paluajtshme, si dhe nuk ka asnjë procedurë ligjore që të kërkojë pajisjen me licencë për ushtrimin e këtij profesioni. Fakti që ky profil edukimi mungonte në tregun e pasurive të paluajtshme, ka bërë që</p>

<p>kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>në bashkëpunim me shoqëritë imobiliare dhe kompanitë e investimeve, të realizohen dy studime tregu nga KU “Wisdom”:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studimi i parë është kryer mbi nevojën e ekzistencës të studimeve profesionale të larta, në Mars të vitit 2018. (Aneksi 2.08); - Studimi i dytë është kryer në Janar 2020. (Aneksi 2.08.1); <p>Nga studimet është konkluduar se tregu i punës i pasurive të paluajtshme ka nevojë për burime njerëzore të kualifikuara në këtë fushë. Ky program studimi ka rezultuar i kërkuar nga studentët që mbarojnë shkollën e mesme, pasi ofron mundësinë e aftësimin në një profesion të kërkuar dhe fitimprurës për një periudhë të shkurtër kohe. Mbështetur në këto studime tregu, si dhe interesin për këtë program studimi, gjykohet se hapja e këtij programi studimi është e justifikuar nga nevojat e tregut të punës për formimin profesional të agjentëve të kualifikuar të pasurive të paluajtshme.</p>			
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Brezi i parë i të diplomuarëve nga ky program do të përfundojë studimet gjatë vitit akademik 2019-2020. Nga pranimi në këtë program në diplomimin, është realizuar punësimi i dy studentëve të programit në agjensi imobiliare. (Aneksi 4.07)</p>			
<p>Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Dy studimet e tregut për këtë program janë bërë në bashkëpunim me agjensitë imobiliare dhe shoqëritë e investimeve. Në analizën vjetore Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Private për vitin akademik 2018-2019 (Aneksi 2.11, fq. 14), ka nënshkruar 16 marrëveshje me kompani të ndryshme, ku 5 kompani janë investimesh dhe agjensi imobiliare të lidhur drejtpërdrejt me tregun e punës për këtë program studimi profesional.</p> <p>Në kuadër të këtyre marrëveshje janë realizuar praktika profesionale dhe punësimi i dy studentëve, si dhe janë zhvilluar veprimtari trajnuese.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>KU “Wisdom” ka një bashkëpunim ndërmjet të gjitha strukturave akademike dhe administrative të tij për realizimin e qëllimeve të programit. Departamenti si njësi bazë e zhillimit të mësimdhënies dhe të punës shkencore, është përgjegjës për programin e studimit, sipas Rregullores së Departamentit të së Drejtës Private. (<i>Aneksi 2.06</i>). Për çdo vit akademik, Departamenti i së Drejtës Private ka hartuar programin e veprimtarive kryesore. (<i>Aneksi 2.10</i>). Në program janë detajuar të gjithë veprimtaritë, koha e realizimit dhe njësitë përgjegjëse për realizimin e tyre. Është përcaktuar bashkëpunimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore, Karrierës dhe Jetës studentore, Komisionin për Veprimtarinë dhe Kurrikulën, Zyrën e Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sekretarinë Mësimore. Marrëdhëniet e frytshme të bashkëpunimit konstatohen gjithashtu në lidhje me koordinimin e punës midis dy njërive kryesore, Fakultetit të Drejtësisë dhe atij të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore (<i>Aneksi 3.03 Plani mësimor</i>), me qëllim përmbushjen e objektivave të planit mësimor të këtij program studimi, me lëndë të natyrës juridike, ekonomike dhe të shkencave të komunikimit.</p> <p>Bashkëpunimi midis stafit akademik si brenda dhe jashtë Departamentit u konstatua nga GVJ edhe gjatë takimit me anëtarë të stafit akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi. Pedagogët shkëmbyen mendime dhe ofruan përvoja me anëtarët e GVJ, në lidhje me përshtatjen më të frytshme për studentët në funksion të formimit profesional më praktik, duke ndryshuar shpërndarjen e ngarkesës së komponentëve të realizimit të programit në një qasje sa më praktike. Gjatë takimit me drejtuesin e njësisë kryesore dhe drejtuesin e njësisë bazë, GVJ u informua se koordinimi dhe bashkëpunimi midis strukturave të KU “Wisdom” mundësohet gjithashtu përmes koordinatores së këtij programi studimi, e cila</p>




	<p>është eksperte e çertifikuar në fushën e pasurive të paluajtshme.</p> <p>Çdo vit akademik bëhet analizë vjetore nga Departamenti i së Drejtës Private, siç është hartuar edhe analiza për vitin akademik 2018-2019 (<i>Aneksi 2.11</i>). Pjesë e rëndësishme e kësaj analize është realizimi i planit vjetor të veprimtarive, statistika mbi studentët, performanca e pedagogëve, bashkëpunimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore, Këshillimin e Karrierës dhe Jetës Studentore, bashkëpunimi me institucione të tjera dhe projektet e kërkim zhvillimit.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>KU “Wisdom” ka ngritur struktura të posaçme përmes të cilave realizon lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimi me institucionet homologe dhe partnere brenda vendit. Sipas Planit Strategjik, marrëveshjet e bashkëpunimit përfshihen ndër prioritetet për sigurimin e cilësisë të KU “Wisdom” (<i>Aneksi 1.03, fq. 10</i>).</p> <p>KU “Wisdom” ka nënshkruar 12 marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit për qëllime të programit të studimit me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluajtshme”, të paraqitura në nën/Dosja D, (<i>Aneksi 4.03</i>). Bashkëpunimi me IAL dhe institucione të tjera paraqitet dhe në analizën vjetore të departamentit të së drejtës private. (<i>Aneksi 2.11, fq. 13</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i së Drejtës Private që ofron programin e studimit me karakter profesional, bën analizë vjetore të punës së realizuar nga departamenti. (<i>Aneksi 2.11</i>), paraqet analizën vjetore për vitin akademik 2018-2019.</p> <p>Gjithashtu, Njësia për Kërkimin Shkencor dhe Marrëdhëniet me Jashtë bën analizë vjetore të punës, ku përfshihen dhe të dhënat nga rezultatet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke përfshirë programe trajnuese, dhe takime me përfaqësues nga Agjenci imobiliare që ushtrojnë veprimtarinë në vend. (<i>Aneksi 4.01</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Departamenti i së Drejtës Private, si njësia përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi studimi, në varësi të nevojave të procesit mësimor ka lidhur marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit me institucionet vendase publike dhe private si dhe me agjenci imobiliare. Bashkëpunimi me këto institucione/studio është në funksion të praktikës profesionale, si dhe, të organizimit të trajnimeve të ndryshme veprimtarive të tjera brenda fushës së këtij</p>

	<p>programi studimi. Sipas raportit të Departamentit të së Drejtës private, për këtë program studimi janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 5 shoqëri imobiliare dhe shoqëri investimesh gjatë vitit akademik 2018-2019. (<i>Aneksi 2.11, fq. 13</i>).</p> <p>Në programin e studimit me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluajtshme”, praktika mësimore është parashikuar 160 orë gjithsej e vlerësuar me 8 ECTS, zhvillohet në vitin e dytë, semestrin e dytë. Njësia përgjegjëse në nivel institucional (NJKSH & MJ) identifikon institucionet e mundshme të bashkëpunimit, duke koordinuar punën e saj me Departamentin e së Drejtës Private, në lidhje me këtë program studimi. Departamenti harton grafikun ku përcaktohen institucionet dhe pedagogët përgjegjës për ndjekjen e praktikës profesionale, si dhe, grupin e studentëve përkatës (<i>Aneksi 3.09</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me agjensi imobilijare dhe kompani investuese, me të cilat, është realizuar punësimi i dy studentëve të programit të studimit në agjensi imobiliare. Sipas (<i>Aneksit 4.07</i>). Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës e Jetës Studentore, si pjesë të detyrës së saj funksionale (<i>Aneks 1.06, neni 6.</i>), realizon lidhjen e studentëve me tregun e punës, duke evidentuar kompanitë apo agjencitë e mundshme për punësimin e studentëve pas diplomimit. Në funksion të punësimit sa më të shpejtë të studentëve pas diplomimit, në vitin 2019, është krijuar dhe Bordi Këshillimor i Biznesit (<i>Aneksi 2.21</i>). Studentët kanë patur mundësi të jenë pjesë e trajnimeve të organizuara nga institucioni për të krijuar kontakte me sipërmarrje dhe punëdhënës në fushën e pasurive të paluajtshme (<i>Aneksi 4.02, Nën-dosja 4: Aneksi 4.06, 4.06.1, 4.06.2, 4.07</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Struktura dhe përmbatja e programit me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluajtshme”, është në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij. Ky program është i organizuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit me karakter profesional është me kohë të plotë, me afat dy vjeçar dhe ka në total 120 kredite, në përputhje me pikën 1, nenin 72 të Ligjit nr. 80/2015.</p> <p>Ngarkesa është ndarë në mënyrë të barabartë, 60 kredite për secilin vit akademik. Procesi mësimor në të dy semestrat është organizuar në leksione, seminare dhe ushtrime. Programi i studimit me karakter profesional përmban 11 lëndë në vitin e parë akademik (9 lëndë të detyrueshme dhe dy lëndë me zgjedhje); 11 lëndë në vitin e dytë akademik (9 lëndë të detyrueshme dhe dy me zgjedhje, duke përfshirë dhe praktikën profesionale). Lëndët/modulet janë nga 4 ECTS deri në 6 ECTS. Të gjitha lëndët/modulet janë semestrare, me përjashtim të lëndës “Ekonomi tregu” që është e përbërë nga dy module dhe ka një shtrirje vjetore përgjatë vitit të parë akademik. Praktika mësimore zhvillohet vitin e dytë pranë kompanive imobiliare me të cilat institucioni ka bashkëpunim dhe ka një ngarkesë prej 160 orësh ose 8 kredite.</p> <p><i>(Aneksi 3.03).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Objektivat formues të këtij program studimi janë shprehur në nenin 10, të rregullores së programit të studimit. <i>(Aneksi 3.01)</i>. Përfundimi i aftësive të agjentit të pasurive të paluajtshme që do të shërbejë tregut në vend dhe jo vetëm, synohet të arrihet me anë të 22 lëndëve, e shtrirë përgjatë dy viteve të studimit. Programi i studimit përmban njohuri nga fusha përkatëse e punësimit duke përfshirë një shumëllojshmëri disiplinash, si lëndë të natyrës juridike që kanë të bëjnë të drejtën e pronësisë, lëndë të natyrës ekonomike, lëndë të natyrës teknike-ndërtimi, dhe lëndë që kanë fokus komunikimin. Gjithashtu, programi përmban edhe lëndën e praktikës profesionale që realizohet në vitin e dytë të studimeve. <i>(Aneksi 3.03)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë</p>	<p>Programi i studimit përbëhet nga një shumëllojshmëri lëndësh të cilat i japin karakter thelbësisht ndërdisiplinor</p>

<p>pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>dhe gjithëpërfshirës këtij programi studimi me karakter profesional. Për ushtrimin e profesionit të agjentit të pasurive të paluajtshme nevojiten njohuri të natyrës juridike, ekonomike, dhe aftësi në fushën e shkencave të komunikimit dhe marketingut. Një pjesë e lëndëve që ofrohen në këtë program studimi kanë në përmbajtjen e tyre ushtrime që synojnë të aftësojnë studentët në praktikë, si në lëndët “Ekonomi Tregu”, “Komunikimi në Real Estate”, “Ekonomi Ambjenti”. Gjitahshtu, gjatë takimit me pedagogë të këtij programi studimi, GVJ u informua se pedagogët kanë shtuar elementë praktikë në formën e rasteve studimore, ose simulimeve, duke marrë parasysh si objektivat e këtij programi studimi, por edhe nevojën për të thjeshtëzuar e konkretizuar njohuritë që u përcohen studentëve. Ndër lëndët me zgjedhje janë cituar dhe lëndë si “shkrimi akademik” dhe “gjuha e huaj”, të cilat për një student që regjistrohet në programin e studimit me karakter profesional “Agjenti i Pasurive të Paluajtshme” janë shumë të rëndësishme. Në kushtet kur tregu i shit-blerjes së pasurive të paluajtshme përfshin gjithnjë e më shumë subjekte në cilësinë e investitorëve ose blerësve që u përkasin nacionaliteteve të ndryshëm, është e nevojshme që agjenti të ketë njohuri bazë në gjuhën angleze dhe të ketë aftësi të mira në të shkruar.</p> <p>Me qëllim plotësimin e gamës së aftësive njohëse praktike, në kuadër të këtij program studimi, janë organizuar një sërë trajnimesh nga profesorë të huaj dhe specialistë vendas, në fushën e menaxhimit të shitjeve, trajnimit për të drejtat e pronësisë, komunikimit në shitjen e pasurive të paluajtshme, etj. Një pjesë e këtyre trajnimeve janë zhvilluar në kuadër të lëndëve të ndryshme të syllabusit të këtij programi. (Aneksi 4.01). Nga ana tjetër, praktika profesionale që zhvillohet në vitin e dytë e përbërë prej 160 orësh dhe që ka 8 kredite organizohet në mënyrë të tillë që studentët të aftësohen për të zgjidhur në praktikë probleme të lidhura me këtë profil pune.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e</p>	<p>Ky program studimi me karakter profesional synon zhvillimin e kompetencave të nevojshme në fushën e pasurive të paluajtshme. Kuadri i lëndëve synon të orientojë studentët për tu përballur në tregun e shit-blerjes dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme përmes njohurive të natyrës juridike, ekonomike, etj. Për më tepër, bashkëpunimi që KU “Wisdom” ka me kompani investitore si</p>

<p>duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>ARMADA shpk dhe agjensi imobiliare që operojnë në vend ka bërë të mundur realizimin e aktiviteteve të ndryshme me studentët e këtij kursi, në formën e diskutimeve duke improvizuar rolet e investitorit, agjentit të shitjeve dhe klientit. (Aneksi 401.1).</p> <p><i>Megjithatë, duhet të theksohet se në tërësi pesha e lëndëve me natyrë praktike, ose komponentëve praktikë në secilën lëndë, duke pasur parasysh natyrën e këtij programi studimi, duhet të ishte më e lartë.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>KU “Wisdom”, përmbush kritret e përcaktuara nga pika 2, neni 20 e Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”. Ky IAL është i përbërë nga 2 fakultete, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Cdo Fakultet është i përbërë nga dy departamente dhe një njësi të kërkimit shkencor. Fakulteti i Drejtësisë në vitin akademik 2019-2020, ka në përbërje të tij 22 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 21 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 1 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Referuar (<i>Aneks 2.18.2.3.4.5 Te dhena tabelore per personelin akademik ne njesite kryesore.pdf</i>), Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2019-2020 është:</p> <p><u>Departamenti i së Drejtës Publike:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada; - 1 PAK me titull; <p><u>Departamenti i së Drejtës Private:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada; <p><u>Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë/FD:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada; <p>Ky program studimi manaxhohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe pëkatësisht njësia bazë Departamenti i së Drejtës Private, në përputhje me kriterin e përcaktuar nga pika 4, neni 25 e ligjit nr. 80/2015, ku departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore dhe tituj akademikë. Në përputhje me të dhënat e (<i>Aneks 2.18.2.3.4.5 Te dhena tabelore per personelin akademik ne njesite kryesore.pdf</i>), Departamenti</p>

	i të drejtës private ka 7 pedagogë të brendshëm, nga të cilët 1 ka titullin Prof.Dr, 2 Doktor shkencash, 1 Docent dhe 3 Msc.			
Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Objektivat e këtij program studimi janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. (Aneksi 3.01). Objektivat janë të qartë dhe në funksion të plotësisht të nevojave të tregut të punës në këtë profil, duke qënë i vetmi program studimi në rang Republike që ofron këtë lloj formimi profesional. Gjithashtu, kompetencat e përfuara në këtë program studimi përcaktohen edhe në suplementin e diplomës (Aneksi 3.09).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënësve, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Programi i studimit me karakter profesional ka informacion të detajuar për objektivat, veprimtarinë formuese me qëllim arritjen e objektivave dhe punësimin e studentëve. Objektivat e planit të studimit janë të përcaktuara në Planin Strategjik 2018-2021 për këtë program. (Aneksi 2.09). Objektivat formues janë të përcaktuara qartësisht edhe në nenin 10, të rregullores të programit të studimit (Aneksi 3.01). Më gjërësisht, veprimtaria formuese e programit të studimit, duke marrë

	<p>në konsideratë mundësitë e punësimit, është përcaktuar në (Aneksin 3.04).</p> <p>Të gjithë studentët e këtij programi me karakter profesional, i kanë të përcaktuara mundësitë e punësimit, si pranë agjensive imobiljare ose shoqërive investuese. Programi ka një sërë bashkëpunimesh me biznese që operojnë në këtë fushë me qëllim, ndër të tjera, krijimin e kontakteve për punësimin e studentëve dhe zhvillimin e praktikës. (Aneksi4.07) Nuk ka ende të dhëna për punësimin e studentëve në këtë program studimi, pasi brezi i parë i diplomuar përfundon studimet në vitin akademik 2019-2020.</p>															
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Plani mësimor i këtij program dy vjeçar studimi përmban në total 120 kredite, të ndarë në mënyrë të barabartë 60 kredite për secilin vit akademik. Nëse i referohemi kërkesave të VKM nr. 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019, sipas klasifikimit të bërë nga vetë KU “Wisdom”, sipas (Aneks 3.04 Veprimtaria formuese e programit APP.pdf)</p> <p>Veprimtaria formuese e programit përbëhet nga:</p> <p>lëndë bazë (26.6 % e krediteve);</p> <p>lëndë karakterizuese (50% e krediteve);</p> <p>lëndë ndërdisiplinore (13.35% e krediteve);</p> <p>praktika mësimore (6.6% e krediteve);</p> <p>Detyrime përmbyllëse (3.3 %)</p> <p>Ballafaqimi i shpërndarjes së këtijraporti midis standardit të VKM dhe vlerësimit të bërë nga KU “Wisdom” është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="635 1406 1299 1890"> <thead> <tr> <th>Tipi i komponentit mësimor</th> <th>Sipas VKM 41/2018 (e ndryshuar)</th> <th>Sipas klasifikimit të bërë nga KU “Wisdom”</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Lëndët bazë</td> <td>10-15%</td> <td>26.6%</td> </tr> <tr> <td>Lëndët karakterizuese</td> <td>45-55%</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td>Lëndë ndërdisiplinore</td> <td>5-15%</td> <td>13.3%</td> </tr> <tr> <td>Lëndë plotësuese</td> <td>10-15%</td> <td>6.6% (Praktika)</td> </tr> </tbody> </table>	Tipi i komponentit mësimor	Sipas VKM 41/2018 (e ndryshuar)	Sipas klasifikimit të bërë nga KU “Wisdom”	Lëndët bazë	10-15%	26.6%	Lëndët karakterizuese	45-55%	50%	Lëndë ndërdisiplinore	5-15%	13.3%	Lëndë plotësuese	10-15%	6.6% (Praktika)
Tipi i komponentit mësimor	Sipas VKM 41/2018 (e ndryshuar)	Sipas klasifikimit të bërë nga KU “Wisdom”														
Lëndët bazë	10-15%	26.6%														
Lëndët karakterizuese	45-55%	50%														
Lëndë ndërdisiplinore	5-15%	13.3%														
Lëndë plotësuese	10-15%	6.6% (Praktika)														

	Përmbyllëse	3-5%	3.3%
	<p>Nga krahasimi i shpërndarjes së veprimtarisë formuese sipas kategorizimit të bërë nga KU "Wisdom", rezultojnë se ky program studimi ka një përqindje të lartë të lëndëve bazë, në raport me standardin e vendosur nga VKM. 41/2018 (e ndryshuar), si dhe ka një përqindje shumë të ulët të lëndëve plotësuese, ku përfshihet edhe praktika mësimore.</p> <p><i>Për këtë arsye, sugjerojmë rishikimin e programit me qëllim standardizimin e lëndëve në përputhje me kërkesat e VKM 41/2018 (e ndryshuar).</i></p>		
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Referuar planit mësimor programi i studimit përfshin informacionin mbi numrin e orëve në auditor dhe jashtë auditorit për çdo lëndë/modul të ndarë në javë akademike/semestra (<i>Aneksi 3.03</i>).</p> <p>Programet mësimore të programit të studimit, janë të detajuara në (<i>Aneksin 3.08</i>). Këto programe janë hartuar sipas formatit të përcaktuar nga shtojca nr. 3 e VKM nr. 41 datë 24.01.2018 (e ndryshuar) dhe përmbajnë të gjithë elementët e domosdoshëm të cituar në të. Departamenti i të Drejtës Private që ofron këtë program studimi, ka miratuar një format për vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve, që duhet të plotësohet nga pedagogët deri në fund të semestrit që dokumenton realizimin e programit të lëndës, frekuentimin, vlerësimin e dijeve, etj. (<i>Aneksi 2.13.4</i>)</p>		
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Programet mësimore (<i>Aneksi 3.08</i>) dhe plani kalendarik i vënë në dispozicion në takimin me pedagogët në KU "Wisdom", kanë të detajuar për çdo javë mësimore me temat e leksioneve, temat e seminarëve/ ushtrimeve dhe disa prej tyre përmbajnë dhe metodat pedagogjike të përdorura. Gjithashtu, për praktikën mësimore është detajuar mënyra e ushtrimit dhe verifikimit të kryerjes së praktikës mësimore.</p>		
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Programi me karakter profesional synon të përgatisë studentë të cilët do të punësohen si agjent të pasurive të paluajtshme.</p> <p>Programi mësimor (<i>Aneksi 3.03</i>), përmban disa lëndë që janë të njëjta me programet bachelor, <i>GVJ rekomandon të riformatohen dhe të thjeshtohen disa lëndë për t'ju përshtatur më mirë këtij programi</i>. Këtu përfshihen lëndë</p>		

	<p>si si për shembull “E drejtë biznesi”, “Mikroekonomi” dhe “Makroekonomi, “E drejtë tregtare”.</p> <p>Gjithashtu, syllabuset e disa lëndëve duhet të garantojnë më shumë fleksibilitet në funksion të përfshirjes së elementëve kyç për këtë program studimi. Më konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lënda legjislacioni mbi tatimet dhe taksat, mund të fokusohet në legjislacionin mbi tatim taksat që lidhet me pasuritë e paluajtshme, konkretisht me aspekte të taksimit të pasurive të paluajtshme, se sa të procedurave tatimore; 2. Lënda “Parimet themelore të financës dhe menaxhimi financiar”, mund të fokusohet në financimin e pasurive të paluajtshme; 3. Lënda ”Ekonomi ambjenti”, mund të fokusohet në ndërtimin dhe probleme që lidhen me impaktin në mjedis të ndërtimeve; <p><i>Gjithashtu, në ofertën e lëndëve me zgjedhje mund të kishte më shumë lëndë që i përshtaten profilit të agjentit të pasurive të paluajtshme, duke shmangur lëndë si “E drejta nërkombëtare private”.</i></p>				
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p><i>Nga vëzhgimi i planit mësimor, rezulton se mësimi praktik, sidomos në vitin e parë të studimit, zë një peshë më të vogël se ai teorik. (Aneksi 3.03). Programi i studimit “Agjent i pasurive të paluajtshme”, sipas të dhënave të aneksit 3.04, ka një peshë të madhe të lëndëve bazë që zënë 26.6% të programit ose 32 ECTS (që zhvillohen pothuajse të gjitha në vitin e parë) dhe një peshë relativisht të vogël të lëndëve plotësuese (ku përfshihet edhe praktika mësimore) që zënë 6.6% të programit ose 8 ECTS.</i></p> <p>Disa nga lëndët në planin mësimor përmbajnë seksion ushtrimesh, megjithatë, këto të fundit përbëjnë 4.6% të totalit prej 120 kreditesh. GVJ gjatë takimit me stafin akademik në institucion evidentoi gadishmërinë e stafit për të ndryshuar raportin e orëve në auditor në favor të orëve të ushtrimeve dhe elementëve praktikë.</p> <p><i>Bazuar në këto gjetje, rekomandohet që të rishikohet plani mësimor me qëllim shtimin e peshës së lëndëve që kanë natyrë praktike.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="616 1809 798 1906">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="798 1809 976 1906">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="976 1809 1155 1906">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1155 1809 1337 1906">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

			X	
--	--	--	---	--

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Elementët e programit të studimit të ofruar, emërtimi i lëndëve, struktura e vitit akademik, ndarja në orë e kredite janë në përputhje me parashikimet ligjore të VKM nr. 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019.
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Programi synon të përgatisë studentë që do të punojnë si agjentë të pasurive të paluatshme. Nga përmbajtja e plan programit (<i>Aneksi 3.03</i>) dhe veprimtaria formuese (<i>Aneksi 3.04</i>), ky program studimi mundëson arritjen e objektivave formuese për shkak të natyrës ndërdisiplinore të tij, që vjen në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit si dhe me punësimin e studentëve në tregun e pasurive të paluajtshme.
Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Plani mësimor (<i>Aneksi 3.03</i>) dhe të gjithë syllabuset e lëndëve që janë bashkëngjitur planit mësimor, përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar nga VKM nr. 41 datë 24.01.2018 të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019, përkatësisht shtojca 3. Syllabuset e çdo lënde përmbajnë informacionin e duhur në lidhje me përmbajtjen e lëndës, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar. Literatura është e përcaktuar dhe për çdo temë që gjendet në syllabuset e lëndëve.
Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.	VKM nr. 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019, në përputhje me këtë kriter të standardit II parashikon se duhet të ketë një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik kundrejt atyre praktik, gjithashtu 25% e programit duhet t'i dedikohet aftësimin në profesion. Veprimtaria formuese e programit përbëhet nga lëndë bazë (26.6 % e krediteve), lëndë karakterizuese (50% e krediteve), ndërdisiplinore (13.3%

	<p>e krediteve), praktika mësimore (6.6% e krediteve) dhe provimi përfundimtar me 3.3% të krediteve.</p> <p>Bazuar në të dhënat e <i>(Aneksit 3.04)</i>, praktika mësimore zë vetëm 6.6% të totalit të krediteve dhe nuk plotëson standardet e vendosura nga ky kriter, sipas të cilit 25% e programit duhet të jetë aftësim praktik/punë konkrete në profesion.</p> <p>Gjithashtu, edhe nëse llogarisim si orë praktike orët e seminarëve dhe të ushtrimeve dhe praktikën mësimore për çdo lëndë, këto të fundit përbëjnë në total 44.5 ECTS, ose jo më shumë se 37% të totalit të krediteve të këtij programi studimi. <i>(Aneks. 3.03 Plani mësimor dhe 3.04 Veprimtaria formuese 3.04)</i></p> <p>Nga takimi me pedagogët, GVJ u informua se pavarësisht se raporti midis lëndëve me natyrë praktike është i vogël, ata kanë bërë përshtatje gjatë zhvillimit të mësimin duke shtuar elementë praktikë në formën e rasteve studimore, simulimeve ose dhe duke aftësuar studentët përmes trajnimeve me ekspertë të jashtëm.</p> <p><i>Për sa më sipër rekomandojmë, të rishikohet plani mësimor me qëllim përshtatjen me kërkesat e këtij kriteri, përmes zvogëlimit të peshës së lëndëve të formimit të përgjithshëm dhe të rritjes së peshës së lëndëve me natyrë praktike dhe praktikës mësimore.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi studimit është hartuar në përputhje me objektivat formues dhe me qëllim orientimin e studentit drejt përshtatjes me kërkesat e tregut në fushën e pasurive të paluajtshme. Programi përmban njohuri në disa fusha që janë relevante për këtë profil profesionisti në tregun e punës. <i>(Aneksi 2.08)</i></p> <p><i>Bazuar në argumentet e mësipërme, raporti midis formimit teorik dhe atij praktik nuk plotëson tërësisht kërkesat për të qënë një raport i balancuar, në përmbushje të objektivat e një programi studimi me karakter profesional.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit, krahas planit mësimor (<i>Aneksi 3.03</i>), programeve mësimore (<i>Aneksi 3.08</i>), është i shoqëruar edhe me plan kalendarik për secilën lëndë. Në planin kalendarik janë të detajuara temat e leksioneve, temat e seminarëve dhe metoda pedagogjike e përdorur. Ngarkesa në auditor dhe format e kontrollit të njohurive për këtë program studimi, janë specifikuar në aneksin 2.14.</p> <p>(<i>Plani kalendarik është vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehitë e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar në bazë të nevojave të tregut imobiliar në Shqipëri dhe synon të përgatisë agjent të pasurive të paluajtshme që do të shërbejnë kryesisht këtij tregu. Bazuar në studimin e tregut, profesion i agjentit të pasurive të paluajtshme ofrohet aktualisht nga individë që nuk kanë formim të posaçëm, dhe ky profesion nuk është ende i rregulluar ligjërisht. (<i>Aneksi 2.08</i>)</p> <p>Plani mësimor përmban lëndë që synojnë të nxisin dhe të zhvillojnë njohuritë juridike, ekonomike, aftësitë e komunikimit, të cilat janë të kërkuara nga një punëdhënës potencial në këtë sektor.</p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit synon aftësimin e studentëve pjesëmarrës në aspekte ligjore, ekonomike dhe teknike të lidhura me pasuritë e paluajtshme, si dhe pajisjen me aftësi shprehëse dhe komunikuese në këtë fushë. (<i>Aneksi 3.08</i>).</p> <p>Në planin kalendarik, janë të specifikuar metodat pedagogjike që përdoren për realizimin e programit. Në raportet semestrale për departamentin (<i>Aneksi 2.15.5</i>) janë evidentuar metodat e mësimdhënies të përdorura dhe rezultatet e kursit. Kontrolli i dijes realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë procesit mësimor, me gojë ose me shkrim (<i>sipas kreut V, neni 14 të Rregullores së Departamentit e të Drejtës Private, Aneksi 2.06</i>) dhe analizës vjetore të departamentit (<i>Aneksi 2.11</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim të njohurive, aftësive dhe</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional, krahas praktikës mësimore, që zhvillohet në vitin e dytë, semestrin e dytë që ka 8 ECTS, përmban edhe disa lëndë që synojnë të rrisin njohuritë praktike të tilla si:</p>

shkathësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	<ul style="list-style-type: none"> - Negocimi në real estate me 4 ECTS; - Komunikimi në real estate me 4 ECTS; - Marketingu dhe profesionistët e shitjes në real estate me 6 ECTS; - Lidhshipi dhe menaxhimi i kohës me 4 ECTS; - Psikologjia e shitjes me 4 ECTS; (<i>Aneksi 3.03</i>). <p>Gjithashtu, stafi akademik përbëhet nga ekspertë në fushën e pasurive të paluajtshme, atë të ndërtimit, të komunikimit të cilët mundësojnë aftësimin e studentëve përgjatë zhvillimit të mësimin.</p>			
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Ky program studimi koordinohet nga një prej anëtarëve të stafit akademik e cila është drejtuese e departamentit të trajnimeve në kompaninë imobiliare CENTYRY 21 për Shqipërinë, Maqedoninë dhe Kosovën, duke mundësuar bashkëpunim me agjenci imobiliare dhe shoqërite e investimeve që janë partnere për qëllime të zhvillimit të këtij programi studimi (<i>Aneksi 2.15, Aneksi 2.18.1</i>). Në kuadër të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit, Departamenti ka realizuar disa trajnime për studentët e këtij programi nga specialist të fushës me qëllim rritjen e aftësive praktike në fushën e pasurive të paluajtshme. (<i>Aneksi 4.06</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikatat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të	Në përputhje me nenin 6, pika 24 e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”, KU “Wisdom” ka ngritur strukturat e vlerësimit të brendshëm. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në KU “Wisdom”

<p>vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të nenit 103 të Ligjit Nr. 80/2015. Ajo është e përbërë nga 5 anëtarë ku një prej anëtarëve është student (<i>Aneksi 2.15</i>). NJSBC operon në bazë të rregullores që përcakton strukturën dhe funksionimin e kësaj njësie. (<i>Aneksi 1.04 Rregullore e Njësisë së Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë</i>). Për çdo vit akademik, kjo njësi ushtron funksionet e saj në bazë të njëplani NJSBC (<i>Aneksi 2.15.2</i>).</p> <p>NJSBC përgatit, miraton dhe organizon pyetësorë, përpunon pyetësorë për student dhe pedagogë. (<i>Aneksi 2.15.03 Modele të pyetësorve</i>). (<i>Aneksin 2.15.4 Model pyetësori pedagogu</i>). Kjo strukturë bën kontrollë semestrale dhe harton relacione të detajuara për ditën, orën dhe angazhimin e pedagogut në mësimdhënie, duke kontrolluar regjistrat personalë, planin kalendarik akademik për lëndët, regjistrin mësimor dhe syllabusin (<i>Aneksi 2.15.6</i>).</p> <p>Gjithashtu, organizon takim me pedagogët dhe studentët në çdo semestër, për ecurinë e procesit mësimor duke evidentuar problematika, sipas (<i>Aneksit 2.16</i>). Në funksion të këtij procesi, pedagogët hartojnë dhe dorëzojnë raporte semestrale, ku pasqyrohet ndërmjet të tjerave përmbushja e objektivave të lëndës (<i>Aneksi 2.15.5</i>). NJSBC harton raport vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, (<i>Aneksi 1.07</i>). Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike dhe diskutohen në nivel njësie bazë. Nga takimi me përfaqësuesit e NJSBC në KU “Wisdom”, GVJ u informua lidhur me procedurat e ndjekura për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit që ofron ky IAL, duke u fokusuar tek specifikat e evidentuara nga vlerësim i programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”.</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Komponentët mësimorë kryesorë janë përcaktuar në nenin 18 të Rregullores së programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” dhe përfshijnë, mësimin në auditor, leksione, seminare, ushtrime praktika në terren apo intership (<i>Aneksi 3.01</i>). Në programet mësimore (<i>Aneksi 3.08</i>) vetëm një pjesë e moduleve ka të specifikuar metodën pedagogjike që do të përdoret për realizimin e secilës temë.</p>

<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Për këtë program studimi me karakter profesional është gjykuar se është shumë e nevojshme përfshirja e profesionistëve në fushën e pasurive të paluajtshme në mësimdhënie përmes leksioneve të ekspertëve të ftuar të cilët ofrojnë këshilla dhe udhëzime në lidhje me ushtrimin e profesionit të agjentit të pasurive të paluajtshme. Këto veprimtari janë mundësuar duke vendosur koordinatorë programi, një trainere dhe oficerë zhvillimi në CENTURY 21 për Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi (<i>Aneksi 2.11.1 dhe 2.18.1</i>). Me anë të trajnimeve që janë zhvilluar në kuadër të moduleve të caktuara si për shembull trajnim me Real Estate Group, datë 22.01.2020 me Century 21 në kuadër të lëndës “Negocim në real estate” ose ato në fushën e marketingut në pasuritë e paluajtshme. (<i>Aneksi 4.01.1</i>)</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga vëzhgimi i dokumentacionit të dorëzuar nga KU “Wisdom”, posaçërisht nga të dhënat e CV të stafit akademik (<i>Aneksi 2.18.1</i>) si dhe nga Relacioni i kalendarit të kontrollit të NjSBC (<i>Aneksi 2.15.6</i>), dëshmohet se pedagogët e angazhuar në këtë program studimi kanë njohuritë e duhura për shpjegimin e koncepteve kryesore të lëndëve. Duke pasur parasysh natyrën ndërdisiplinore të këtij programi studimi, në lëndë të ndryshme përdoren metoda të ndryshme, duke përfshirë si kazuset, ose rastet studimore, etj. (<i>Aneksi 3.08</i>) <i>Vlen të theksohet se për pjesën më të madhe të programeve të lëndëve, nuk përfshihen në syllabus metodat e përdorura nga pedagogu, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre me kërkesat e një programi profesional studimi.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik i këtij programi studimi, ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme dhe në programin Erasmus të shkëmbimit (<i>Aneksi 2.11</i>). Nga vizita në KU “Wisdom”, dhe posaçërisht nga takimi me përfaqësuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, GVJ u informua se pedagogët e këtij programi studimi janë trajnuar nga koordinatoresha e këtij programi studimi, e cila është eksperte në fushën e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, pedagogët kanë marrë pjesë në trajnimet e realizuara në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me agjencitë imobiliare partnere. (<i>Aneks 4.01 Analizë vjetore e NjKSHMJ</i>)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Intrastruktura e shtrytëzueshme për këtë program studimi është e mjaftueshme, funksionale dhe cilësore për realizimin e objektivave të këtij programi studimi. (Aneksi, 2.22 <i>Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”</i>)</p> <p>Godinat ku zhvillohet mësimi janë marrë me qira në bazë të kontratave të qirasë të cilat gjenden në dokumentacionin e dorëzuar për qëllime të akreditimit të këtij programi studimi. Afati i qerasë është 5 vjeçar që dëshmon qendrueshmëri afatshkurtër dhe afatmesëm për mbulimin e nevojave për mjedise ku zhvillohet procesi mësimor. (Aneksi 2.23, Aneksi 2.24).</p> <p>Hapësirat e vëna në dispozicion nga KU “Wisdom” plotësojnë normat minimale të hapësirës për student dhe pedagog dhe staf administrativ. Konkretisht, norma $m^2/student: 1006m^2/256\ studentë = 3.93m^2/student$, ndërsa mjedise për stafin: norma $m^2/person\ 229m^2/35\ persona = 6.5m^2/person$ (Aneksi 2.22).</p> <p>Megjithatë, mungon vetëm ashensori në dy godinat, gjë e cila do të mundësonte aksesin në të gjitha sallat e seminareve dhe leksioneve të studentëve që mund të kenë aftësi të kufizuara që i vështirësojnë lëvizjen. Nga vizita e GVJ në KU “Wisdom”, GVJ pati mundësi të kqyrte të gjitha mjediset në funksion të procesit mësimor si dhe të shërbimeve që u ofrohen studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Si studentët ashtu edhe stafi akademik i KU “Wisdom” mund të shfrytëzojnë infrastrukturën e IT në funksion të realizimit të procesit mësimor si dhe të komunikimit midis tyre. Të gjitha sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisura me pajisje projektimi si dhe laptop. Gjithashtu, biblioteka ofron 45 poste pune, akses në internet, dhe 12 laptop. Studentët dhe pedagogët kanë akses në bibliotekën online. Kolegji universitar ka nënshkruar kontratë me ProQuestLLC dhe ka akses në faqen elektronike</p>

	<p>https://ebookcentral.proquest.com/lib.central/Wisdom. (Aneksi 1.12)</p> <p>Gjithashtu biblioteka e KU “Wisdom” është pjesë e sistemit kombëtar bibliografik COBISS.AL dhe përfaqësohet me bibliotekën virtuale (Aneksi 2.17). Gjithashtu, për qëllime të zhvillimit të lëndës me zgjedhje “Informatikë civile dhe tregtare” është në dispozicion laborator i informatikës, i cili është i pajisur me kompjutera funksionalë dhe në numër të mjaftueshëm për studentët e këtij programi studimi. KU “Wisdom” ka hartuar, gjithashtu, udhëzues për monitorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit. (Aneks 1.08)</p> <p>Për studentët dhe stafin akademik dhe administrativ të KU “Wisdom” është në funksion Portali i Studentit, si një platformë komunikimi dhe shkëmbimi të brendshëm të informacionit, që aksesohet përmes kredencialeve personale të studentit. (Aneksi 2.14.1 Portali i studentit)</p> <p>KU “Wisdom” ka faqe zyrtare www.Wisdom.edu.al. ku në përputhje me politikat institucionale për publikimin e informacionit (Aneksi 1.10) publikohen informacione për studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”, në nenin 9, specifikohet se gjuha e studimit në këtë program është gjuha shqipe (Aneksi 3.01).</p> <p>Bazuar në të dhënat për programet e studimit (Aneksi 3.08), literatura bazë në pjesën më të madhe të lëndëve është kryesisht në gjuhën shqipe. Nga vëzhgimi i secilit program lënde rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i lëndës “Arkitekturë dhe zhvillim urban” dhe ai i lëndës “Parimet e vlerësimit të pronave”, e kanë literaturën bazë në anglisht, por janë të shoqëruara me përmbledhje leksionesh në shqip nga pedagogët e lëndës; - Ka edhe disa programe lëndësh që literaturën bazë e kanë në gjuhën angleze dhe shqipe si “Komunikimi në real estate”, “Negocimi në real estate”, “Lidershipi dhe menaxhimi i kohës”, “Psikologjia e shitjes”. Edhe për këto lëndë ka përmbledhje leksionesh në shqip; <p>Gjatë vizitës në KU “Wisdom” dhe takimit me pedagogët e lëndëve, GVJ shprehu shqetësimin në lidhje caktimin e</p>

	<p>literaturës bazë në gjuhën angleze në lëndët e sipërcituara. Pedagogët sqaruan se, në përputhje me temën e secilës lëndë pedagogët u japin studentëve përmbledhje ose prezantim të leksionit në gjuhën shqipe.</p> <p>Literatura ndihmëse është përgjithësisht në gjuhën shqipe, atë angleze dhe vetëm në një programin e lëndës “E drejtë tregtare” është edhe në gjuhën italiane.</p> <p><i>Bazuar në sa më sipër, rekomandohet, që të shikohet mundësia e shtimit të literaturës në gjuhën shqipe, ose të publikimit/shpërndarjes të cikleve të leksioneve në gjuhën shqipe për studentët e këtij programi studimi nga pedagogët e lëndëve përkatëse.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në bibliotekën e KU “Wisdom” për Fakultetin e Drejtësisë janë në dipozicion 162 tituj fizik, duke përfshirë dhe tekstet bazë të këtij programi studimi. Materialet në përbërje të fondit të bibliotekës janë të aksesueshëm online në katalogun COBISS.AL (<i>Aneksi 2.25</i>).</p> <p>KU “Wisdom” është i regjistruar pranë bazës së të dhënave online “Proquest”, në të cilën 151, 238 tituj janë të aksesueshëm vetëm në fushën e drejtësisë. (<i>Aneksi 2.17</i>).</p> <p>Literatura në gjuhën angleze është e gjerë dhe i shërben programit të studimit pasi pothuajse të gjitha lëndët kanë literaturë ndihmëse në këtë gjuhë (<i>Aneksi 2.17</i>). <i>Njohja e mirë e gjuhës angleze nga studentët e këtij kursi është e nevojshme me qëllim shrytëzimin e të gjitha materialeve të kursit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni është i pajisur me laborator informatike prej 30m² (<i>Aneksi 2.22</i>), në bibliotekë ka akses në internet dhe 12 laptopë të shfrytëzueshëm nga studentët. (<i>Aneksi 2.17</i>).</p> <p>Programi i studimit nuk ka në përmbajtje të tij orë laborator, por nëse studentët zgjedhin lëndën “Informatikë civile dhe tregtare”, mund të përdorin mjediset e laboratorit të informatikës. (<i>Aneksi 3.03</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të këtij programi studimi është platforma “Portali i Studentit” e cila mundëson shkëmbimin e materialeve midis pedagogëve dhe studentëve. (<i>Aneksi 2.14.1 Portali i studentit</i>). Në kuadër të zhvillimit të mësimin online për shkak të situatës së krijuar nga COVID -19, KU “Wisdom” përmes Zyrës së IT ka ofruar suport të vazhdueshëm me qëllim garantimin e aksesit të studentëve në platformat e e-learning si Google Meet dhe Zoom. Nga vizita në institucion, GVJ u informua se asistencë u është</p>

	dhënë edhe pedagogëve të përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi, me qëllim lehtësimin e zhvillimit të mësimin online.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	<p>Në Planin Strategjik (<i>Aneksi 1.03</i>), një nga prioritetet e KU “Wisdom”, është vënia në funksionim të plotë të mekanizmit të kontrollit të cilësisë. Bazuar në pikën 1, neni 27, të Statutit (<i>Aneksi 1.01</i>), NJSBC është strukturë autonome e përhershme. Ajo përbëhet nga 5 anëtarë, ku Këshilli Studentor përfaqësohet me një anëtar në përputhje me Statutin e KU “Wisdom”. (<i>Aneksi 2.15</i>). Detyrat e NJSBC janë përcaktuar në pikën 2, neni 27 i Statutit. (<i>Aneks 1.01</i>)</p> <p>NJSBC vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore –shkencore, harton relacione dhe propozon ndryshime për përmirësime të ndryshme. Në rregulloren e posaçme për NJSBC është përcaktuar funksionimi, veprimtaria dhe organizimi i kësaj njësie (<i>Aneksi 1.04</i>).</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	<p>Bazuar në pikën 3, neni 22, i Rregullores të KU “Wisdom”, departamenti është organi përgjegjës për programet e studimit dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Programi i studimit me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluajtshme” ofrohet nga Departamenti i të Drejtës Private. Krahas rregullores të funksionimit të KU “Wisdom”, është hartuar edhe rregullorja e funksionimit të këtij Departamenti në nenin 8 të të cilit përcaktohen funksionet e tij si dhe qëllimi dhe vizioni.</p> <p>Ndër të është rritja e kapaciteteve të personelit akademik si dhe të ofrojë programet dhe njohuritë më të mira për studentët (<i>Aneksi 2.06</i>). Gjithashtu, funksionet e</p>

	<p>Departamentit në lidhje me këtë program studimi përcaktohen në Rregulloren e këtij programi. (<i>Aneksi 3.01</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Pika 2, neni 16 i Rregullores së programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” përcakton të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik. (<i>Aneksi 3.01</i>). Çdo pedagog duhet të dorëzojë në departament raport semestral për programin e lëndës, në të cilin trajtohet nëse janë përmbushur qëllimet dhe objektivat kryesore të lëndës, materialet e përdorura, metoda e mësimdhënies, kalueshmëria dhe frekuentimi (<i>Aneksi 2.15.5</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në KU “Wisdom”, GVJ u informua se pedagogët janë trajnuar edhe nga koordinatori e këtij programi studimi, e cila është eksperte në fushën e real estate. Gjithashtu, gjatë vitit akademik janë zhvilluar trajnime me pjesëmarrje pedagogë dhe studentë me ekspertë në fushën e pasurive të paluajtshme. Angazhimi i këtyre ekspertëve të ftuar ka mundësuar diversifikimin e metodave të mësimdhënies, duke u orientuar më shumë drejt praktikës.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Personeli akademik ka marrë pjesë në trajnime brenda dhe jashtë vendit, projekte, konferenca shkencore, botime në revista shkencore dhe tekste mësimore. Të dhëna të plota mbi aktivitetet e zhvilluara janë pasqyruar në relacionin e NJKSHMJ (<i>Aneksi 4.06</i>). Gjithashtu, KU “Wisdom”, në projekt buxhetin për vitin 2019-2020, ka parashikuar fondin prej 500,000 lekësh për konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe 1,708,000 lekësh si shpenzime për kërkim –zhvillim për stafin akademik (<i>Aneksi 2.24.2</i>), si dhe me vendim të administratores janë alokuar fonde për qëllime të zhvillimit të stafit akademik. (<i>Aneski 2.27</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në planin mësonor (<i>Aneksi 3.03</i>) është përcaktuar për çdo lëndë ngarkesa totale e ndarë në leksione, seminare dhe ushtrime. Ushtrime janë të përcaktuara për 11 module nga 22 që ofrohen gjatë dy viteve të studimit, në varësi të specifikave të lëndës.</p> <p>Në planin kalendarik të çdo pedagogu janë specifikuar metodat pedagogjike që do të përdoren me qëllim arritjen e objektivave të kursit. Në përfundim të kursit hartohet relacion për programin e lëndës, që ka si synim të analizojë nëse janë përmbushur objektivat e kursit (<i>Aneksi 2.15.5</i>).</p>

	Gjatë vizitës në KU “Wisdom”, GVJ u informua se duke pasur parasysh natyrën e këtij programi studimi me karakter profesional, me numër relativisht të vogël studentësh është krijuar mundësia që temat e mësimit të jenë interaktive. Studentët angazhohen për të zgjidhur situata praktike, si dhe marrin pjesë në simulime.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Pika 1 dhe 2, neni 79 e Rregullores së KU “Wisdom”, përcaktojnë se për vlerësimin e dijes pedagogu mbështetet në kontrollin e vijueshëm, pjesëmarrjen në leksione, seminare, praktika, kolegiume dhe frekuentimi. Procedurat e kriteret e vlerësimit, janë të përcaktuara në nenin 21 të Rregullores të programit të studimit (<i>Aneksi 3.01</i>). Gjithashtu, format e kontrollit të dijes janë të përcaktuara në syllabuset e programeve mësimore (<i>Aneksi 3.08</i>).</p> <p>Rregullorja e Departamentit e Drejtë Private (<i>Aneksi 2.06</i>), kreu V, kontrolli dhe vlerësimi i dijes, nga neni 14 deri në nenin 31 përcakton të gjithë rregullat e kontrollit të dijes, provimeve, procesverbalëve, ankimimit për rregullat e zhvillimit të provimit dhe ankimimi i rezultateve të provimit. Në pikën 2, neni 25, të Rregullores të Departamentit përcaktohet se kërkesa ankimore dhe dokumentacioni përkatës, depozitohen një kopje në sekretarinë mësimore, e cila e administron së bashku me fletën e provimit dhe procesverbalin përkatës. Neni 27 i Rregullores të sekretarisë mësimore, të gjitha përfundimet e studentit, përfshi kreditet ECTS e siguruar dhe të akumuluar, regjistrohen në kartelën e tij. Të drejtën për ta administruar kartelën e ka vetëm kryesekretari (<i>Aneksi 1.05</i>).</p> <p>KU “Wisdom” nuk ka miratuar një rregullore të posaçme për mëyrën e testimit dhe vlerësimin e njohurive dijeve dhe aftësive. Megjithatë, të gjitha modalitetet e lidhura me</p>

	<p>vlerësimin e studentëve janë të rregulluara gjerësisht në kuadrin ekzistues rregullator të këtij IAL.</p>
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit (<i>Aneksi 3.01</i>), pika 1, neni 21, për vlerësimin e njohurive janë përcaktuar forma të ndryshme “<i>testimi i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave</i>”</p> <p>Pika 3, neni 21 e rregullores të programit të studimit, “<i>format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentit</i>”.</p> <p>Bazuar në të dhënat e programeve mësimore vlerësimi i njohurive bëhet përmes mënyrave të mëposhtme (<i>Aneksi 3.08</i>):</p> <p>Lëndët: E drejtë biznesi; Psikologjia e shitjes, Bazat e menaxhimit, Marketingu dhe profesionistët e shitjes në Real Estate, Menaxhim dhe mirëmbajtje pronash; Arkitekturë dhe zhvillim urban, Komunikim në real estate, Parimet e vlerësimit të pronave; kanë në programin e tyre dy teste me 5% secili, ese, detyrë kursi 10% dhe provim përfundimtar 70%. Ky grup lëndësh zë 35% të totalit.</p> <p>Lëndët: E drejtë tregtare; Lidërsip dhe manaxhimi i kohës; Aftësi menaxheriale; Gjuhë angleze; Regjimi juridik i pasurive të paluajtshme; Legjislacioni mbi tatimet dhe taksat; Veprat penale kundër pasurisë; Negocimi në Real estate; Detyrime dhe kontrata; Ekonomi ambjenti; Shkrim akademik; E drejta e sigurimeve shoqërore; kanë në vlerësimin e tyre: pjesëmarrja aktive në seminare 10%, detyrë kursi, kolegium ese 20%, provim përfundimtar 70%. Ky grup lëndësh zë 52% të totalit.</p> <p>Lënda ekonomi tregu, frekuentimi 10%, pjesëmarrja aktive në seminare, diskutime teste 10%, ese detyrë kursi 10%, provim përfundimtar 70%.</p> <p>Lëndët: Parimet bazë të financës dhe menaxhimit financiar dhe Vlerësimi i menaxhimit të riskut bazohen në vlerësimin: frekuentim 10%, diskutim 10%, provim i ndërmjetëm 20% dhe provim përfundimtar 60%.</p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e</p>	<p>Programet mësimore (<i>Aneksi 3.08</i>) kanë të specifikuarat format e vlerësimit të modulit që i bëhen të ditura studentëve në fillim të modulit. Studentët nëpërmjet aksesit në portalin studentor, mund të informohen për përmbajtjen e kursit të studimit, të drejtat dhe detyrimet</p>

<p>shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>(<i>Aneksi 2.14.1</i>). Gjithashtu, çdo pedagog lënde që përfshihet dhe angazhohet në ditët e orientimit, krahas një prezantimi të përgjithshëm të lëndës, nje studentët me mënyrat e vlerësimit për lëndën përkatëse. Studentëve u vihen në dispozicion modele teza kolokiumi dhe provimi përfundimtar në mënyrë që të njihen me mënyrën e testimit të njohurive. (<i>Aneks 2.13.2 Model/template, Tezë kolokiumi, Aneks 2.13.3 Model/template, Tezë provimi përfundimtar</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Departamenti i të Drejtës Private, si njësi përkatëse akademike, monitoron në vijimësi procesin e kontrollit të dijeve duke siguruar një proces në përputhje me rregullat e përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit. Bazuar në të dhënat e programeve mësimore (<i>Aneksi 3.08</i>), provimi përfundimtar në të gjitha modulet e këtij kursi zë 70% të vlerësimit total me përjashtim të dy lëndëve: “Parimet bazë të finances” dhe “menaxhi financiar”, dhe “Vlerësimi i menaxhimit të riskut”, ku provimi përfundimtar zë 60%. Kjo ndarje në përqindje dëshmon për një balancim të sistemit të kontrollit të dijeve, si përmes vlerësimit në testin përfundimtar, ashtu edhe përmes vlerësimit për gjatë vitit akademik.</p> <p>Provimet realizohen në respektim të parimit të transparencës. Sipas pikës 1, tëneni 20, Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private, “<i>provimet me shkrim bëhen me fletë të sekretuara të cilat vulosen nga sekretaria mësimore. Ato vendosen në zarf dhe hapen para studentëve dhe komisionit në momentin e fillimit të provimit</i>” (<i>Aneksi 2.06</i>).</p> <p>Gjithashtu, neni 26 i Rregullores të Sekretarisë Mësimore, “<i>Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim brenda 15 ditëve nga data e dhënies së provimit.</i>” Përveç procesit të sekretimit, nuk rezultojnë të jenë shfrytëzuar sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, përmes të cilave do të mundësohej rritja e paanësisë në vlerësim dhe transparencë në mënyrën e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente</p>	<p>Në përbërje të komisioneve të provimit të çdo lënde, të ngritura nga drejtuesi i departamenti, janë titullari i lëndës dhe së paku një pedagog tjetër asistent. Komisionet</p>

<p>e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>përkatëse ngrihen në bazë të rregullave të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit (<i>Aneksi 1.02 neni 84 dhe Aneksi 3.01</i>). Rregullorja e KU “Wisdom” ashtu edhe Rregullorja e Programit të Studimit, parashikojnë në detaje mënyrën organizimit të procesit të vlerësimit të njohurive. (<i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes, neni 84, 85 dhe 88</i>).</p> <p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit, përcaktohet komisioni i provimit dhe përbërja e tij (<i>Aneksi 3.01 neni 23 pika 1</i>). Gjithashtu, pedagogët bëjnë konsultime individuale me studentët me qëllim këshillimin e tyre për përballjen me të gjitha fazat e vlerësimit. (<i>Aneks 3.01, Neni 19/2</i>)</p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Në aktet rregullatore të KU “Wisdom” të zbatueshme për këtë program studimi, përcaktohet mënyra e komunikimit të rezultateve si dhe mundësitë e ankimit. (<i>Aneksi 1.02, neni 87 aneksi 2.05 neni 55/2</i>), procesverbali i vlerësimit dorëzohet në sekretari jo më vonë se dy javë nga dita e provimit përfundimtar. Vlerësimi i studentëve dokumentohet në procesverbalet përkatëse dhe pasqyrohen në regjistrat përkatëse (<i>neni 25 i rregullores së programit</i>). Dokumentacioni i vlerësimit të provimeve firmoset nga pedagogët përkatës në përfundim të procesit (<i>Aneksi 3.01</i>). Sipas nenit 77, e Rregullores së KU “Wisdom”, të dhënat personale të studentëve ruhen dhe përpunohen bazuar në parimet e konfidencialitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në përputhje me pikën 1 neni 58 të Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë dhe pika 1, neni 25 e Rregullores së Departamentit të Drejtës Private (<i>Aneksi 2.06</i>), studentët kanë të drejtë të paraqesin brenda tre ditëve nga marrja e vlerësimit, ankesë me shkrim. Në pikën 1, neni 58 e Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë, përgjigja për ankesën e vlerësimit merret jo më vonë se 5 ditë nga dita e paraqitjes të ankesës nga komisioni ad-hoc i ngritur nga Departamenti.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				
<p>Standardi III.5 Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e</p>				

zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>Agjenti i pasurive të paluajtshme, në punën e tij realizon ndërmjetësim të transaksioneve të pasurive të paluajtshme. Për të qenë i suksesshëm në këtë treg, për një profesionist të kësaj fushe nevojiten një sërë aftësish të tilla si komunikimi i mirë, negocimi, aftësitë në fushën e marketingut, njohuritë për regjimine taksave që aplikohen në tregun imobiliar, dhe për vlerësimin e pasurive të paluajtshme. Këto janë pjesë e objektivave formues të programit të studimit, neni 10 e Rregullores së programit të studimit. <i>(Aneksi 3.01)</i></p> <p>Gjithashtu, plani mësimor është i përbërë nga një mori lëndësh me karakter ndërdisiplinor, duke mundësuar kështu përfitim e aftësive profesionale të veçanta të studentëve për këtë program studimi. <i>(Aneksi 3.03)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Për të qenë një agjent i suksesshëm i pasurive të paluajtshme teknologjia, ose marketingu digjital krahas atij klasik, janë të nevojshëm për të promovuar shërbimet e ofruara. Në vitin e parë të studimit, ofrohet moduli “Marketingu dhe profesionistët e shitjes në real estate”. Pjesë e këtij moduli është edhe tema “marketing në epokën digjitale”, që analizon edhe e –commerce. <i>Trajtimi vetëm me një temë mësimore është i pamjaftueshëm për t’u ofruar studentëve njohuri në fushën e marketingut digjital në këtë fushë. (Aneksi 3.03 dhe 3.08)</i></p> <p>Në planin mësimor <i>(Aneksi 3.03)</i> në vitin e dytë të studimit ofrohet si lëndë me zgjedhje “Informatikë civile dhe tregtare”. <i>Bazuar në rëndësinë që ka marketingu digjital për këtë profesion, mund të konsiderohet që të ofrohet si lëndë e detyrueshme.</i></p> <p>Plan programi përmban disa lëndë që synojnë të përmirësojnë aftësitë shprehëse dhe komunikative të studentëve si Komunikimi në Real Estate, Shkrim Akademik, Negocimi në real estate, Psikologjia e shitjes, Lidershipi dhe Menaxhimi i kohës, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë</p>	<p>Në këtë program profesional studimi, pedagogët e lëndëve/moduleve hartojnë në përfundim të realizimit të programit mësimor të lëndës përkatëse një realacion përmes të cilit evidentojnë përmbushjen e detyrimeve nga</p>

<p>njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>ana e studentëve dhe vlerësimin e përgjithshëm për realizimin e këtyre vlerësimeve. Relacioni përmban dhe arritjet dhe përmirësimet e mundshme të punës së pedagogut dhe studentit për përmbushjen e detyrimeve mësimore. Për qëllime të realizimit të formimit praktik, Departamenti i së Drejtës Private që ofron programin e studimit, ka 16 bashkëpunime me komunitetin e biznesit dhe tregun e punës (<i>Aneksi 2.11, fq. 14</i>). Një pjesë e këtyre bashkëpunimeve janë me agjensi imobiliare dhe shoqëri investimesh, që lidhen me programin e studimit në analizë.</p> <p>Praktika profesionale zhvillohet në vitin e dytë, semestri i dytë dhe ka një ngarkesë 160 orë, ose 8ECTS (<i>Planit mësimor, Aneksi 3.03</i>). Për zhvillimin e praktikës, është hartuar një udhëzues përkatës (<i>Aneksi 2.14.2</i>).</p> <p>Në programet mësimore (<i>Aneksi 3.08</i>) janë temat orientuese për praktikën profesionale. Në përfundim të praktikës studenti vlerësohet me notë në bazë të aftësive të tij në përgatitjen, prezantimin dhe dorëzimin e një dosje. Në programin e praktikës janë të përcaktuara aktet që duhet të përmbajë dosja që duhet të përgatisë studenti. Studentët e këtij programi studimi nuk janë pjesë e programeve të mobilitetit Erasmus +.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Të gjithë pedagogët dorëzojnë në fund të semestrit, raportin semestral. Ky raport përmban, ndër të tjera, edhe analizën SWOT, pika të dobëta dhe pika të forta të modulit dhe mundësinë për përmirësime (<i>Aneksi 2.15.5</i>).</p> <p>Në përfundim të çdo semestri bëhet takim i stafit pedagogjik me studentët në prani të NJSBC (<i>Aneksi 2.16</i>). Në këtë takim diskutohet ndër të tjera dhe për zhvillimin e leksioneve dhe seminarëve, aktivizimin e studentëve në projekte kërkimore –shkencore. Për takimet e realizuara hartohen relacione.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>KU “Wisdom” ka procedura për mbështetjen e studentëve në procesin e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Bazuar në pikën 1, neni 97 i Rregullores së KU “Wisdom”, (aneksi 1.02) dhe në pikën 1, neni 64 në Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë (<i>Aneksi 2.05</i>), në përfundim të studimeve dhe fitimit të krediteve të nevojshme, studentët kanë të drejtë të diplomohen për të fituar titullin përkatës. Përfundimi i studimeve dhe diplomimi është rregulluar në nenet 64-73, të Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë.</p>

	<p>Diploma dhe suplementi i diplomës (<i>Aneksi 3.09 dhe 3.10</i>), janë në përputhje me përcaktimet e nenit 91, të ligjit nr.80/2015 dhe Udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, në fushën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.</p> <p>Gjithashtu, në Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet se pedagogët ofrojnë konsultime për studentët përgjatë vitit akademik si dhe para provimeve (<i>Aneks. 3.01 neni 19</i>). Për këtë program studimi nuk ka ende një brez të parë të të diplomuarëve.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Kërkesat e këtij kriteri plotësohen nga departamenti përgjegjës, konkretisht Departamenti i së Drejtës Private. Pika 2, neni 19 e Rregullores së Programit të Studimit (<i>Aneksi 3.01</i>), përcakton ofrimin e ndihmës së nevojshme studentit me konsultime, për përgatitjen e kologiumit, punimeve për seminarin, provimit dhe punimit të diplomës.</p> <p>Pika 4 dhe 5, neni 20 i Rregullores së Programit të Studimit, përcaktojnë se pedagogët ofrojnë konsultime për studentët. Asistencë ofrohet edhe gjatë zhvillimit të praktikës profesionale. Praktika profesionale zhvillohet nën drejtim të stafit të përcaktuar nga departamenti. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, pedagogu e drejton atë, mban lidhje me qendrën ku ajo realizohet. Në programet mësimore (<i>Aneksi 3.08</i>) pas programit të Praktikës Profesionale është bashkëlidhur Vendimi nr. 113 prot., datë 12.12.2019 i Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë për caktimin e pedagogëve mbikqyrës për realizimin e praktikës profesionale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Rregullat dhe procedurat e punësimit të stafit akademik të KU “Wisdom” janë të përcaktuara në një sërë aktesh rregullatore të brendshme të këtij IAL. Konkretisht në Statutin e KU “Wisdom” parashikohet procedura e rekrutimit të kandidatëve si dhe kriteret për lidhjen e kontratës së punës dhe për caktimi i kohëzgjatjes së kontratës në përputhje me kategorinë përkatëse të personelit akademik (Profesor/Lektor/Asistent-lektor). <i>(Aneks 1.01 Statuti i KU “Wisdom”, Neni 45, Punësimi i personelit akademik dhe Neni 46.1, Kontrata e punës.)</i></p> <p>Gjithashtu, në Rregulloren e KU “Wisdom” parashikohet kategorizimi i stafit akademik si dhe referohet në statutin e IAL për çështje që lidhen me statusin, me të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik. <i>(Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom”, Neni 33 paragrafi 7)</i>. Ndërsa në Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore përcaktohet mënyra e realizimit të procedurave të rekrutimit në bashkëpunim me njësitë e tjera të KU “Wisdom” <i>(Aneks 1.06, Neni 6, pika 1 dhe 2.)</i></p> <p><u>Procedurat e rekrutimit të stafit akademik përfshijnë disa faza ndër të cilat mund të përmenden:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -përcaktimi i nevojës nga njësia bazë përkatëse; - vendosja e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pozicionit të punës; - publikimi i njoftimit në faqen e internetit të KU “Wisdom” në përputhje me politikat institucionale të publikimit të informacionit; - ngritja e komisionit <i>ad hoc</i> që do të vlerësojë kandidatët; - vlerësimi i këtyre të fundit (përmes dosjes dhe intervistës);

	<p>- shpallja e rezultateve dhe lidhja e kontratës me fituesin; Parashikimet në rregulloret e mësipërme janë në përputhje me kërkesat e nenit 57, 58, 59 dhe 67 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”.</p> <p>GVJ u është vënë në dispozicion nga KU “Wisdom” disa prej akteve të brendshme të miratuar në kuadër të një procedure rekrutimi për pozicion vakant për vitin akademik 2019-2020. (Aneks 2.19 Vendim Nr. 316 prot, datë 11.09.2019 “Për identifikimin e pozicioneve vakante për personel akademik VA 2019-2020 në Departamentin e së Drejtës Private, Aneks 2.19.1 Kriteret e konkurimit, Aneks 2.19.2 Propozim Dekani për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit dhe përzgjedhjes për personel akademik me kohë të plotë për VA 2019-2020, Aneks 2.19.3 Vendim Rektori Për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe përzgjedhjes së për personel akademik me kohë të plotë për VA 2019-2020 të Fakultetit të Drejtësisë.)</p> <p>Përpos dokumentacionit të sipërcituar, gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësi të njihej me dokumentacionin që mban Zyra e Burimeve Njerëzore e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore për qëllime të rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme pranë KU “Wisdom”, Fakulteti i Drejtësisë dhe posaçërisht për programin e studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”. (Aneks 2.18 <i>Formati i dosjes personale të stafit.</i>)</p> <p>Nga dosjet e inspektuara rezulton se informacioni është i plotë dhe i renditur në mënyrë kronologjike. Krahas akteve të organeve të përcaktuara në statut për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, përfshihen dhe fletët e vlerësimit për secilin kandidat si dhe procesverbali i mbledhjes së komisionit <i>ad hoc</i>.</p> <p>(Aneks 1.10 <i>Politika institucionale e publikimit të informacionit</i>),</p>
<p>Kriteri2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për</p>	<p>Të dhënat në lidhje me stafin akademik përfshihen në dosjen personale të stafit, e cila është e organizuar përmes një sistemi inventarizimi për çdo dosje. (Aneks 2.18 <i>Formati i dosjes personale të stafit</i>), (Aneks 2.18.2 <i>Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe Njësinë përgjegjëse</i>). (Aneks 2.18.3 <i>Të dhëna</i></p>

<p>organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p><i>tabelore për personelin akademik në programin e studimit.</i>)</p> <p>Gjithashtu, Zyra e Burimeve Njerëzore e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore mban të dhëna mbi angazhimin (me kohë të plotë/pjesëtime) të stafit akademik në lëndën/lëndët dhe ngarkesën përkatëse për vitin akademik 2018-2019 dhe të përditësuar për vitin akademik 2019-2020. (<i>Aneks 2.18 Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësitë kryesore</i>)</p> <p>Njësia përgjegjëse për organizimin e programit të studimit është Departamenti i së Drejtës Private. (<i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom"</i>). Departamenti në cilësinë e njësisë përgjegjëse për shpërndarjen e ngarkesës mësimore për çdo anëtar të personelit akademik, përcakton gjithashtu edhe tutorët që ndjekin praktikën mësimore.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me dosjet me të dhënat për çdo pedagog, si dhe pati mundësi të informohej nga pedagogët e angazhuar në tutorimin e zhvillimit të praktikës nga studentët në lidhje me mbarëvajtjen e këtij komponenti të studimeve, edhe gjatë periudhës së situatës së shkaktuar nga Covid-19.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>KU "Wisdom" ka vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme didaktike dhe kërkimore si dhe hapësirën personale të punës për çdo pedagog. (<i>Aneksi, 2.22 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit me karakter profesional "Agjent i Pasurive të Paluajtshme"</i>)</p> <p>Për lëndë specifike si lënda me zgjedhje "Informatikë civile dhe tregtare" është vënë në dispozicion laborator i informatikës, duke mundësuar kushte optimale për zhvillimin e kësaj lënde. Nga vizita e GVJ në KU "Wisdom" rezultoi se ky laborator është funksional dhe është në gjendje të akomodojë plotësisht studentët e programit të studimit me karakter profesional "Agjent i Pasurive të Paluajtshme".</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Aneks 2.18.2.3.4.5 Te dhëna tabelore për personelin akademik në njësitë kryesore.pdf, tabelat 5 dhe 6</i>), të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë dy viteve akademike janë si më poshtë:</p>

	<p>Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 18 pedagogë ndër të cilët 17 PAE, nga ku 10 me grada dhe 1 PAK.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 95% PAE dhe 5% PAK.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 janë të angazhuar 9 pedagogë të gjithë PAE, nga ku 5 me grada/tituj.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 100% nga PAE.</p> <p>Nga vizita në KU “Wisdom”, GVJ u informua nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe përgjegjësi i Departamentit të së Drejtës Private në lidhje me veprimet e ndërmarra në funksion të optimizimit të shpërndarjes së ngarkesës stafit akademik të këtij programi studimi me natyrë ndërdisiplinore. Stafi i angazhuar përfshihet në mësimdhënie dhe në programe te tjera të studimit që ofrohen nga KU “Wisdom”. Të gjithë pedagogëve rezultoi t’u jenë ofruar mundësi të barabarta për të kryer detyrat e tyre në kuadër të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në lidhje me kualifikimin e personelit akademik rezultoi se gjatë vitit akademik 2018-2019 dhe 2019-2020 janë marrë masa për mbështetjen e veprimtarisë kërkimore shkencore me vendim të administratores së KU “Wisdom” për mbështetjen e veprimtarive kërkimore shkencore për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020. (<i>Aneks 2.27 dhe Aneks 2.27.1 Vendim i Administratores së shpk Wisdom për mbështetjen</i>)</p> <p>Në buxhetin për vitin akademik 2019-2020 parashikohet si zë i veçantë “<i>Shpenzim për kërkim zhvillim stafi akademik</i>” (Aneksi, 2.22 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” dhe projekt buxheti për vitin 2019-2020). Nga relacioni i analizës vjetore të Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënive me Jashtë, rezultoi se që prej vitit akademik 2018-2019 janë zhvilluar aktivitete shkëmbimi me pedagogë të huaj dhe trajnime për studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi, në fushat e komunikimit, menaxhimit, marketingut në fushën e pasurive të paluajtshme, vlerësimin e pronës, etj. (<i>Aneks 4.01 Relacion i analizës vjetore të Njësisë së kërkimit shkencor dhe marrëdhënive me jashtë</i>), (<i>Aneks 4.06</i></p>

	<p><i>Relacion të aktiviteteve të realizuara me ekspertë të ftuar në IAL.)</i></p> <p>Gjithashtu, stafit akademik i është vënë në dispozicion aksesi në bazat e të dhënave ProQuest dhe COBBISS.AL me qëllim mundësimin e kërkimit shkencor por dhe zhvillimit profesional për qëllime të rritjes së kapaciteteve pedagogjike për këtë program studimi.</p> <p>Në planin e veprimtarive kërkimore shkencore për vitin akademik 2019-2020 parashikohen objektivat e kërkimit shkencor si dhe produktet e pritshme. <i>(Aneksi 4.02 Plani i veprimtarisë kërkimore shkencore për vitin akademik 2019-2020)</i></p> <p><i>Përpos sa më sipër, stafi akademik rezulton të jetë trajnuar specifikisht për çështje që lidhen specifikisht me programin e studimit me karakter profesional "Agjent i Pasurive të Paluajtshme".</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Ky program studimi ka në total 21 studentë gjithsej;</p> <p>11 në vitin e pare;</p> <p>10 në vitin e dytë;</p> <p><i>(Aneksi 2.12. Të dhëna tabelore për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve të programit të studimit me karakter profesional "Agjent i Pasurive të Paluajtshme").</i></p> <p>Bazuar dhe në planin mësimor të lëndëve teorike që zhvillohen gjatë periudhës dy-vjeçare të studimeve për këtë program studimi mjediset e vëna në dispozicion nga institucioni janë mëse të mjaftueshme në raport me numrin e studentëve për këtë program studimi. <i>(Aneks 2.22-2.24 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit</i></p>

	<p>të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”)</p> <p>Godinat në përdorim, sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorit i informatikës, biblioteka, janë të pajisur me pajisje të teknologjisë së informacionit, kanë hapësira të mjaftueshme dhe plotësojnë standardet e vendosura nga VKM Nr 418 datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e instucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”. Sipas VKM standardi minimal i hapësirës në këtë tushë studimi është 2.5 m² për student. Në rastin e këtij programit studimi, hapësira e akorduar është 3.93 m²/ student. Gjatë vitizës në institucion, GVJ pati mundësi të kqyrte të gjitha mjediset ku zhvillohen orët e seminareve, leksioneve dhe laboratory dhe konstatoi që hapësirat ishin të mjaftueshme, të ajrosura dhe të pajisura me mjetet e duhura për zhvillimin e orëve të mësimi. Gjithashtu, në mjediset e KU “Wisdom” studentëve u mundësohen mjedise çlodhëse dhe pushimi.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar për qëllim të akreditimit si dhe nga vizita e GVJ në institucion konstatohet se KU “Wisdom” ka vënë në dispozicion pajisjet e nevojshme elektronike në funksion të zhvillimit të këtij programi studimi. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me laptop dhe projektorë, duke u krijuar mundësinë pedagogëve për të shfrytëzuar makimalisht teknologjinë në zhvillimin e orëve mësimore.</p> <p>Gjithashtu, studentëve u vihen në dispozicion mundësi për të aksesuar burime bashkëkohore të mësimnxënies përmes aksesit në platformën online dhe në bibliotekën online. (Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online / Struktura e teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online etj.)</p> <p>Aneks 2.22 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit, Aneks 1.08 Udhëzues për monitorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.)</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi</p>	<p>Për qëllime të shfrytëzimit për këtë program studimi, KU “Wisdom” ka vënë në dispozicion laboratorin e informatikës me pajisje të mjaftueshme për zhvillimin e lëndës me zgjedhje “Informatikë civile dhe tregtare”. Mirëmbajtja e pajisjesve të këtij laboraatori realizohet nga struktura e teknologjisë së informacionit pranë KU</p>

teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>“Wisdom” (<i>Aneksi 2.22 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit. Aneks 1.08 Udhëzues për monitorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.</i>)</p> <p>Për zhvillimin e lëndëve të tjera për këtë program studimi profesional nuk paraqitet e nevojshme shtimi i laboratërëve të tjerë.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>KU “Wisdom” ka siguruar për këtë programi studimi laboratorin e informatikës. Të gjithë kompjuterat në sallën e laboratorit janë funksionalë dhe të pajisur me programet kompjuterike përkatëse, dhe mund të shfrytëzohen nga studentët gjatë zhvillimit të lëndës me zgjedhje “Informatikë civile dhe tregtare”. Gjatë vizitës në KU “Wisdom”, GVJ pati mundësi të kqyrte mjediset e këtij laboratorit dhe i gjeti në përputhje me nevojat e këtij programi studimi.</p> <p>(<i>Aneks 2.22 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit, Aneks 1.08 Udhëzues për monitorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit</i>)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>Praktika profesionale zhvillohet bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me agjenci imobiliare dhe subjekte të tjera private si shoqëri ndërtimi.</p> <p>Në këto marrëveshje citohet se institucioni pritës mundëson marrjen e të gjitha masave për zhvillimin e praktikës mësimore dhe u mundësojnë atyre aplikimin e njohurive të marra në ambjentin e punës si dhe bashkëpunon në organizimin e veprimtarive trajnuese, etj. (Shembull: Marrëveshje Bashkëpunimi midis KU “Wisdom” dhe REMAX/INFINITY)</p> <p>(<i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet, Aneks 4.04 Marrëveshjet në nivel institucional/Fakulteti i Drejtësisë</i>);</p> <p>(<i>Aneks 4.05 Marrëveshjet në nivel Program Studimi me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme</i>)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijojnë kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>KU “Wisdom” ka vënë në dispozicion të këtij programi studimi bibliotekën mësimore (<i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” Neni 112, Biblioteka</i>), (<i>Aneks 2.22 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i>), (<i>Aneks 2.24.4 Informacion i përgjithshëm në lidhje me Bibliotekën e KU “Wisdom”</i>), e cila përbëhet nga fondi fizik i librave si bazat e të dhënave online. Biblioteka është e pajisur me kompjutera në sasi të mjaftueshme për studentët e këtij programi studimi dhe studentëve të tjerë të KU “Wisdom”, duke u mundësuar studentëve akses në internet, në programet e Microsoft Office, me qëllim mundësimin e përgatitjes së detyrave dhe temave sipas nevojës. (<i>Aneks 1.13 Të dhëna të plota për platformat on-line/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/Biblioteka online.</i>)</p> <p>Të gjithë studentët e këtij programi studimi mund të aksesojnë bibliotekën pa pagesë shtesë. Përpos garantimit të mundësisë së shfrytëzimit të bibliotekës, KU “Wisdom” ka përgatitur dhe manual përdorimi për bazat e të dhënave që ofron kjo bibliotekë. (<i>Aneks 2.24.3 Trajnim për përdoruesit e programit COBBIS.</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në një kënd të veçantë të bibliotekës është e vendosur dhe literatura bazë e pjesës më të madhë të lëndëve që zhvillojnë studentët në këtë program studimi. Krahas literaturës bazë, në fondin fizik të bibliotekës përfshihet dhe një pjesë e literaturës së rekomanduar, aktet ligjore dhe nënligjore relevante për degën e studimit si dhe revista shkencore në gjuhën shqipe. Për Fakultetin e Drejtësisë janë në dispozicion 162 tituj fizik, si dhe me revista shkencore në fushën e së drejtës si “Kuvendi” dhe “Jeta Juridike”. Një pjesë e literaturës ndihmëse në gjuhë të huaj, kryesisht atë angleze, mund të aksesohet edhe përmes bazave të të dhënave online. Fondi i bibliotekës është pasuruar për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020 me tituj në fushën e së drejtës, relevante për fushën e programit të studimit. (<i>Aneksi 2.17 Relacion për Bibliotekën e KU “Wisdom” Nr. 138 prot, datë 07.01.2020. Bashkëlidhur</i>)</p>

	<i>lista e teksteve/ periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit)</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Biblioteka e KU “Wisdom” mundëson aksesin në kushte të barabarta për të gjithë studentët dhe pa pagesë shtesë në bazat e të dhënave online në të cilatë rezulton të jetë i regjistruar KU “Wisdom” (<i>Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat on-line/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/Biblioteka online</i>).</p> <p>Biblioteka është pjesë e sistemit kombëtar bibliografik COBISS.AL dhe përfaqësohet në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë COBIB.AL dhe çdo student ose pedagog i KU “Wisdom” mund të regjistrohet dhe të aksesojë falas këtë bazë të dhënash. Gjithashtu, KU “Wisdom” është i regjistruar pranë bazës së të dhënave online “Proquest”, në të cilën 151, 238 tituj janë të aksesueshëm vetëm në fushën e drejtësisë. (Aneksi 2.17 Relacion për Bibliotekën e KU “Wisdom” Nr. 138 prot, datë 07.01.2020. Bashkëlidhur lista e teksteve/ periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.)</p> <p>Fondi i bibliotekës është përditësuar dhe shtuar në dy vitet e fundit akademike me tekste të reja në fushën e së drejtës. (Aneksi 2.17 Relacion për Bibliotekën e KU “Wisdom” Nr. 138 prot, datë 07.01.2020. Bashkëlidhur lista e teksteve/ periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.) Në projekt-buxhetin për vitin 2019-2020 parashikohen si zë në buxhetin e Fakultetit të Drejtësisë shpenzime për bibliotekeën në masën 550 000 L. Megjithatë, nuk specifikohet nëse këto shpenzime janë për mbulimin e kostove për platformat online dhe mirëmbajtjen e fondit ekzistues, apo për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj. <i>Nuk rezulton të ketë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës me qëllim përditësimin e fondit ekzistues.</i></p> <p>(Aneks 2.26 Projekt-buxheti për vitin akademik 2019-2020)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të</p>	<p>KU “Wisdom” ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me qëllim realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Përpos marrëveshjeve në nivel institucional (Aneks 4.03 Relacion tabelat e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet, Aneks 4.04 Marrëveshjet në nivel institucional/Fakulteti i Drejtësië) janë lidhur dhe marrëveshje në nivel programi studimi</p>

<p>institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>(Aneks 4.05 Marrëveshjet në nivel Program Studimi me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”) me qëllim zhvillimin e praktikave mësimore por edhe shkëmbimin e ndërsjelltë të ekspertizës mbi bazën e parimit të reciprocitetit. Në klauzolat e marrëveshjeve përcaktohet dhe vënia në dispozicion të studentëve të materialeve të nevojshme për zhvillimin e praktikës mësimore dhe marrja e masave për aftësimin praktik të studentëve. <i>(Shembull: Aneksi 4.05 Bashkëpunimi midis KU “Wisdom” dhe REMAX/INFINITY).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Në dokumentacionin financiar të dorëzuar për qëllime të akreditimit gjenden të dhëna për mbështetjen financiare për këtë program studimi. Në Planin Strategjik për periudhën 2018-2021 <i>(Aneksi 2.09)</i> parashikohen burimet e financimit ku përfshihen tarifat e studentëve dhe financime të tjera që mbulojnë koston e shkollimit të vëna në dispozicion nga “Wisdom” sh.p.k.</p> <p>Gjithashtu, të dhënat nga Projekt-buxheti për vitin akademik 2018-2020 si dhe raporti financiar për tre vitet e fundit dëshmojnë për mbulimin e shpenzimeve për ciklin e parë të plotë të studimit 2018-2020. Duke qënë se nuk është përmbyllur ende një cikël i parë i plotë studimi, nuk është hartuar ende raporti financiar për mbylljen e një cikli të plotë studimi.</p> <p><i>(Aneks 2.24.2 Projekt-Buxheti për vitin akademik 2019-2020);</i></p> <p><i>(Aneks, 2.24.4 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme për 3 vitet e fundit);</i></p>
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Të dhënat financiare dëshmojnë për mbulimin e veprimtarive të qëndrueshme dhe ato operative që mundësojnë realizimin e objektivave të programit të studimit, ku ndër të tjera mund të përmenden shpenzimet operative për Fakultetin e Drejtësisë, shpenzimet e administrimit të Fakultetit të Drejtësisë dhe Ekonomisë, dhe shpenzimet në nivel institucional. Të ardhurat në total për tri vitete e fundit janë më të larta se shpenzimet ne total gjë e cila dëshmon për qëndrueshmërinë financiare të institucionit të dhe të njësisë kryesore, Fakulteti i Drejtësisë, e cila është përgjegjëse për zbatimin e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Aneks 2.24.2 Projekt-Buxheti për vitin akademik 2019-2020)</i></p>

	<i>(Aneks, 2.24.4 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme për 3 vitet e fundit)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Kriteret e përzgjedhjes dhe pranimit të kandidatëve për programin e studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” si dhe bërja e tyre publike bazohen në Ligjin 80/2015 dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve me karakter profesional dhe janë të përcaktuara në një sërë aktesh të miratuara nga organet vendimmarrëse të KU “Wisdom”, duke përfshirë këtu Statutin e KU “Wisdom”, Rregulloren përkatëse të programit të studimit, si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit përcaktohen dokumentet që duhet të dorëzojë aplikanti dhe klasifikimi i kandidatëve bëhet në bazë të kriterëve që përcaktohen me vendim të Senatit Akademik të KU “Wisdom”. Në këndin e njoftimeve të KU “Wisdom” përfshihen të dhëna dhe udhëzime për aplikimin për programin e studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” për vitin e ri akademik 2020-2021. (https://wisdom.edu.al/njoftime/articles/NJOFTIM64)</p> <p>Gjithashtu, në përputhje me politikat institucionale të publikimit të informacionit, (Aneks 1.10) në faqen e internetit të KU “Wisdom” (www.wisdom.edu.al) ka një seksion të posaçëm dhe të dedikuar për orientimin e studentëve, mbi programet dhe tarifat e studimit, mundësitë që ofron tregu i punës, mundësinë e akordimit të bursave të studimit, zhvillimin e praktikave mësimore, si dhe mjediset e zhvillimit të mësimin. Në të gjenden të publikura Guida e Studentit, Udhëzuesi i Karrierës,</p>

	<p>Udhëzuesi Didaktik për programin “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzuesi i Praktikës. (Aneks 3.10) Të gjithë këto dokumente janë hartuar duke garantuar gjithëpërfshirjen e kandidatëve dhe garantimin e shanseve të barabarta bazuar në kritere unike për të gjithë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto dokumente përmbajnë të dhëna me qëllim orientimin e studentë ve lidhur me programin e studimeve dhe përmbajtjen e tij, kontaktet e rëndësishme në KU “Wisdom”, vendndodhjen e sallave të leksioneve, bibliotekën, të dhëna për fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, si dhe shërbime të tjera që ofron ky IAL, me qëllim përparimin e studentëve gjatë zhvillimit të studimeve.</p> <p><i>(Aneks 1.01 Statuti i KU “Wisdom”, Neni 10, pika f, Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve)</i></p> <p><i>(Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”, Nenet 26-28)</i></p> <p><i>(Aneks 1.05 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU “Wisdom”, Neni 3);</i></p> <p><i>(Aneks 1.10 Politika institucionale e publikimit të informacionit.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për programin e studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” janë miratuar për të dy vitet e fundit akademike me vendim të Senatit Akademik (Aneks 2.13 Vendim Senati Nr. 67 datë 25.03.2019 “Për kriteret e pranimit për VA 2020-2021”. Aneks 2.13.1 Vendim Senati “Për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë”) në përputhje me Rregulloren e programit të studimit <i>(Aneks 3.01)</i></p> <p>Gjithashtu, udhëzimi i kandidatëve potencialë të interesuar zhvillohet dhe përmes ditëve të informimit të maturantëve. Në faqen e dedikuar programit të studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor” nuk përmbahet informacion tjetër përveç planit mësimor (https://wisdom.edu.al/scenario.aspx?xml=programet-2-vjecare-me-karakter-profesional)</p> <p><i>Në të nuk janë përfshirë të dhëna sqaruese në lidhje me organizimin e këtij programi të studimi si dhe rregulloren përkatëse të tij.</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Studentëve të KU “Wisdom” u është vënë në dispozicion informacion në lidhje me zhvillimin e programit të studimit dhe përparimin akademik. Ky proces realizohet përmes informimit nëpërmjet Guidës së Studentit, Rregullores së Programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” (Aneksi 3.01), po gjithashtu edhe informacione që jepen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore gjatë takimeve orientuese. Gjithashtu, gjatë ditëve të orientimit, si stafi administrativ dhe akademik është në funksion të dhënies së informacioneve për zhvillimin e programit të studimit, për sistemin e vlerësimit të dijeve, për zhvillimin e praktikave, etj.</p> <p>Përpos këtyre kanaleve të ofrimit të informacioni, në faqen zyrtare në internet të KU “Wisdom”, ofrohen të dhëna mbi programet mësimore, kalendarin akademik, udhëzuesin e karrierës, dhe mundësinë për të kontaktuar drejtpërdrejtë me strukturat përgjegjëse për avancimin e studentëve. Ndërsa përmes “Portalit të studentit”, studentët kanë mundësi të marrin informacion në lidhje me zhvillimin e lëndëve, por edhe të marrin kontakt të drejtpërdrejtë me pedagogët në lidhje me programet e lëndëve si dhe me vlerësimin e dijeve. (Aneksi 2.14.1 Portali i studentit)</p> <p>Gjithashtu, ndër politikat e marketingut të KU “Wisdom” përfshihen veprimtari që kanë për qëllim shpërndarjen e informacioneve mbi mundësitë e punësimit të studentëve gjatë dhe pas kryerjes së studimeve, asistencën që ofrohet ndaj çdo studenti në rast nevojë si dhe komunikimin përmes rrjeteve sociale. Gjithashtu, gjatë zhvillimit të panairit “Work and study” studentët marrin informacion mbi institucionet që bashkëpunojnë me KU “Wisdom” dhe mundësitë që u ofrohen studentëve për tu angazhuar përmes veprimtarive praktike ose përmes punësimit në të ardhmen. (Aneks 1.11 Politika e Marketing-ut)</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentët e KU “Wisdom” rezultojnë se informohen gjërësisht në lidhje me programin e studimit për të cilin janë regjistruar. Të dhënat në lidhje me programin e studimeve dhe mbështetjen institucionale që ofrohet u mundësohen studentëve si nëpërmjet faqes zyrtare të Web (Aneks 1.09) ashtu edhe nëpërmjet vënies në dispozicion të guidave të posaçme dhe udhëzuesëve. (Aneksi 3.01 dhe</p>

	<p><i>Aneks 2.14 Udhëzues i praktikave “Për programet e studimeve me karakter profesional”)</i></p> <p>Gjithashtu, të gjitha strukturat e KU “Wisdom” përgjegjëse për zbatimin e këtij programi studimi, duke filluar që nga Departamenti i së Drejtës Private, Koordinatorit të Programit të studimit (<i>Aneks 2.11.1 Vendim për caktimin e Koordinatorit të programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”</i>), Sekretaria Mësimore si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore ushtrojnë funksionet e tyre në drejtim të orientimit dhe mbështetjes së studentëve dhe përgatitjes së tyre për tregun e punës. Krahas panairit “Work and study”, gjithashtu, Zyra e Karrierës ka zhvilluar veprimtari trajnuese me qëllim orientimin e studentëve për të përballuar sfidat e tregut të punës, si dhe veprimtari trajnuese ose orientuese posaçërisht për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Aneks 1.11, Aneks 4.06, Aneks 4.07 Aneks 4.07 Shkresat e njoftimeve për punësim dhe internship-e të studentëve të këtij programi.)</i></p> <p>Nga takimi me specialisten përgjegjëse për karrierën, GVJ u njoh me veprimtaritë e zhvilluara dy vitet e fundit në drejtim të përgatitjes së studentëve me aftësitë e nevojshme për të hartuar CV, letër motivimi, profile në rrjete sociale profesionale. Gjithashtu, nga koordinatoresha e këtij programi, GVJ u informua në lidhje me informimin e studentëve për mundësitë që ofrohen nga KU “Wisdom” në kuadër të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor por dhe praktikës që zhvillojnë studentët, atyre u është vënë në dispozicion përmes informacioneve të faqes në internet të KU “Wisdom” një sërë udhëzuesish/guidash mbi programin e studimit dhe mundësitë e punësimit në të ardhmen. Konkretisht, Udhëzuesi i Karrierës, Guida e Studentit, të gjitha të aksesueshme online, përbëjnë një bazë solide për marrjen e informacionit lidhur me këtë program studimi (<i>Aneks 1.09 Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it, Aneks 1.10 Politika institucionale e publikimit të informacionit.</i>)</p> <p>Për këtë program studimi nuk ka një udhëzues didaktik të publikuar. (https://wisdom.edu.al/guida-e-studentit)</p>

	<p>Gjithashtu, studentëve u mundësohet dhe marrja e informacionit mbi veprimtaritë formuese si dhe shërbimet që ofron KU “Wisdom” në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të karrierës dhe Jetës Studentore, përmes zhvillimit të takimeve individuale ose në grup. Zyra mund të kontaktohet në mjediset e KU “Wisdom”, por edhe përmes telefonit ose adresës së emailit</p> <p><i>(Aneks 1.06 dhe Aneks 2.20)</i></p> <p><i>Website: https://wisdom.edu.al/specialist-i-karrieres-dhe-jetes-studentore</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Përpos mundësisë së informimit në auditoret dhe zyrat e KU “Wisdom”, të dhëna mbi programit e studimit gjenden në faqen zyrtare të KU “Wisdom”, duke përfshirë kryesisht planet mësimore dhe informacione mbi zhvillimin e praktikave dhe kalendarin akademik. <i>(Aneks 1.09 Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it)</i> dhe <i>(Aneks 1.10 Politika institucionale e publikimit të informacionit, https://wisdom.edu.al/programet-mesimore).</i></p> <p>Nëpërmjet faqes së internetit të KU “Wisdom” studentëve u mundësohet akses në Portalin e Studentit përmes kredencialeve individuale të çdo studenti (http://portal.hstalb.xyz/). GVJ u informua nga studentët e programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”, lidhur me mënyrën e aksesimit të portalit nga studentët, veçanërisht gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin online si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19</p> <p><i>(Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/Biblioteka online etj.)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>KU “Wisdom” disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”. Për qëllime të menaxhimit nga pikëpamja administrative të të gjithë informacionit dokumentar lidhur me studentët dhe në funksion të procesit mësimor, KU “Wisdom” ka ngritur Sekretarinë Mësimore. Në rregulloren e Sekretarisë Mësimore janë përcaktuar funksionet e Sekretarisë si dhe dokumentacioni që kërkohet nga studentët për qëllime të regjistrimit në secilin program studimit, transferimin e studentëve, mbajtjen e regjistrave dhe matrikullimin e studentëve, frekuentimin, zhvillimin e provimeve.</p> <p><i>(Aneks 1.05 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU “Wisdom”, Neni 2, Funksionet e sekretarisë mësimore.)</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësi të aksesonte dokumentacionin <i>hard copy</i> për studentët e këtij programi studimi, duke përfshirë si dosjet personale, ashtu edhe regjistrat, dhe procesverbalet e notave. GVJ pati mundësi të informohej dhe mbi politikën e privatësisë së ruajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave personale të studentëve si dhe lidhur me mënyrën e funksionimit të sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit.</p> <p><i>(Aneks 1.10 Politika institucionale e publikimit të informacionit, Aneks 1.05 Rregullore e Sekretarisë Mësimore);</i></p> <p><i>(Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/Biblioteka online, etj.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni në lidhje me personelin akademik, atë ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në realizimin e objektivave të programit mundësohet përmes dy strukturave kryesore, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore; 2. Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënive me Jashtë <p><i>(Aneks 1.06 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, Neni 6 dhe</i></p>

	<p><i>Aneks 4.01 Relacion i analizës vjetore të Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.)</i></p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore mban dokumentacion të rregullt mbi personelin akademik dhe dosjet përkatëse mbi të dhënat e tyre dhe procedurat e rekrutimit. (Aneks 2.18 Format i dosjes personale të stafit, Aneks 2.18.3 Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit me karakter profesional, Aneks 2.18.2 Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe Njësinë përgjegjëse, Aneks 2.18.1 CV e stafit akademik të programit të studimit dhe CV e stafit ndihmës akademik.) Gjatë vizitës në KU “Wisdom”, GVJ u njoh me dokumentacionin e mbajtur nga kjo Zyrë në lidhje me anëtarët e personelit të angazhuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme, si dhe me dosjet përkatëse të zhvillimit të procedurave të rekrutimit të personelit, në përputhje me planin e punës së kësaj zyre.</p> <p><i>(Aneksi 2.20, Aneksi 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” Neni 116, Arkiva dhe Protokolli, faqe 48).</i></p> <p>Ndërsa Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë mban dokumentacion në lidhje me të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar KU “Wisdom” për realizimin e objektivave të këtij programi studimi <i>(Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione)</i>, si në drejtim të zhvillimit të praktikave mësimore, ashtu edhe në lidhje me ngritjen e urave të bashkëpunimit si për shkëmbim të ekspertizës, por dhe për rritjen e mundësive të punësimit të studentëve që diplomohen nga programet e studimit që ofron KU “Wisdom”.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Garantimi i aksesit të dedikuar në informacione për personelin akademik dhe për studentët realizohet përmes Portalit të Studentit, i cili aksesohet drejtpërdrejtë nga faqja web e KU “Wisdom”. Në të studentët mund të marrin informacion mbi rezultatet e provimeve, mbi materialet studimore të ngarkuara nga pedagogët për secilën lëndë, informacione dhe njoftime të ndryshme, etj. <i>(Aneks 2.14 Portali i Studentit.)</i></p> <p>Publikimi i informacionit në portal realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe procedurat e përcaktuara në drejtim të ruajtjes së konfidencialitetit të përcaktuara në Politikat Institucionale</p>

	<p>të Publikimit të Informacionit. (<i>Aneks 1.10 Politika institucionale e publikimit të informacionit.</i>)</p> <p>Përpos aksesit të dedikuar, studentëve u është mundësuar që të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me Sekretarinë përmes informacionit të vënë në dispozicion në faqen e internetit të KU “Wisdom”(https://wisdom.edu.al/sekretaria)</p> <p>(<i>Aneks 2.20 Plani i punës së zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe jetës studentore.</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Portali i Studentit është i përbërë nga disa seksione që mundësojnë kontaktin e shpejtë dhe efektiv përmes aksesit të dedikuar midis pedagogëve, studentëve dhe stafit administrativ, për qëllime të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe atij të vlerësimit. Aksesit në portal realizohet përmes kredencialeve të çdo student.</p> <p>(<i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom”, neni 103, sekretaria mësimore;</i>)</p> <p>(<i>Aneks 2.14. Portali i Studentit, Aneks 1.10 Politika institucionale e publikimit të informacionit;</i>)</p> <p>(<i>Aneks 2.20 Plani i punës së Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe jetës studentore;</i>)</p> <p>(<i>Aneks 1.08 Udhëzues për monitorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit;</i>)</p> <p>(<i>Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/Biblioteka online etj.</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit përmes Portalit të Studentit administrohet dhe funksionon nën drejtimin e Zyrës së IT dhe në bashkëpunim me struktura të tjera përfshirë këtu Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Gjithashtu, përmes sistemit të brendshëm të komunikimit me email këto struktura janë në gjendje të përcojnë informacione në kohë reale për drejtuesit e IAL dhe njësisë kryesore në lidhje me mbarëvajtjen e programit të studimit dhe avancimit të studentëve.</p> <p>(<i>Aneks 1.08 Udhëzues për monitorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/Biblioteka online etj.</i>)</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit,</p>	<p>Në faqen e internetit www.wisdom.edu.al gjende të publikuara informacione mbi programet e studimit që</p>

personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	ofrohet nga KU “Wisdom” (https://wisdom.edu.al/cilat-jane-programet-e-studimit-qe-ofron-ku-wisdom), njoftime mbi veprimtaritë e ndryshme që zhvillohen nga KU “Wisdom” (https://wisdom.edu.al/aktivitete) si dhe stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie (https://wisdom.edu.al/Stafi) Seksioni mbi programet e studimit është i aksesueshëm në gjuhën shqipe dhe angleze, ndërsa informacioni mbi stafin akademik dhe njoftimet për veprimtaritë e zhvilluara nga KU “Wisdom” gjenden të publikuara vetëm në gjuhën shqipe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret e pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Hartimi dhe zbatimi i politikave, procedurave dhe kriterëve të pranimit, përparimit dhe transferimit, bazohen në një kuadër rregullator që është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”. Në statutin e KU “Wisdom” parashikohet se kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik (<i>Aneks 1.01 Statuti i KU “Wisdom neni 66</i>), (<i>Aneks 2.13 Vendim Senati për kriteret e pranimit për VA 2020-2021</i>), (<i>Aneks 2.12 Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit të studimit me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluajtshme</i>) Në bazë të Ligjit 80/2015 neni 23

	<p>pika 4 kriteret e pranimit miratohen nga fakultetet bazuar në propozimin e njërive bazë.</p> <p>Gjithashtu, në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore janë përcaktuar dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në një program studimi, kriteret e transferimit të studentëve dhe dokumentacioni i nevojshëm, si dhe procedurat e kontrollit të dijes dhe diplomimi i studentëve. Megjithatë, në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, mungon seksioni që liston dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin në programet e studimit me karakter profesional. Po ashtu, ky seksion mungon edhe në Rregulloren e KU “Wisdom”. Dokumentacioni i kërkuar është përcaktuar në Rregulloren e Programit të studimit</p> <p><i>(Aneksi 3.01, neni 28)</i></p> <p><i>(Aneks 1.2)</i></p> <p><i>(Aneks 1.05 Rregullore e Sekretarisë Mësimore nenet, 4, 8, 13, 24-26)</i></p> <p><i>(Aneks 2.07 Rregullore e transferimeve në Fakultetin e Drejtësisë)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kuadri rregullator dhe ai strategjik përmbajnë norma të cilat nuk kanë natyrë diskriminuese dhe garantojnë të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët në programin e studimit, si në kriteret e pranimit, në aksesin e studentëve në shërbime, në vlerësimin e dijeve përmes një sistemi të anonimizuar, ashtu edhe në diplomimin e tyre. Gjithashtu, veprimtaritë trajnuese me qëllim orientimin e studentëve në tregun e punës, posaçërisht në sektorin e manaxhimit të pasurive të paluajtshme, u janë drejtuar të gjithë studentëve të këtij programi studimi pa asnjë lloj dallimi.</p> <p><i>(Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom”, Neni 21)</i></p> <p><i>(Aneks 1.06 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore)</i></p> <p><i>(Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”, Nenet 26-28)</i></p> <p><i>(Aneks 4.07 Shkresat e njoftimeve për punësim dhe internship-e të studentëve të këtij programi.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe,</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, në përputhje me kuadrin ligjor dhe atë rregullator të miratuar nga Ministria e Arsimit, KU “Wisdom” publikon kriteret e veçanta për</p>

<p>përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>përzgjedhjen e kandidatëve në faqen e internetit U-Albania. (https://ualbania.al/pages/kriteret.html)</p> <p><i>Kriteret e pranimit nuk rezultojnë të jenë të publikura në faqen zyrtare të KU "Wisdom".</i></p> <p>Nga takimi me përfaqësues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, GVJ u informua se KU "Wisdom" angazhon çdo vit pedagogët në ditët e informimit me maturantët, me qëllim prezantimin dhe informimin lidhur me ofertën akademike të këtij IAL. Gjithashtu, në Politikat e Marketingut të KU "Wisdom" parashikohet kombinimi i një sërë mekanizmash që KU "Wisdom" ndërmerr për të marketuar programet e studimit, përfshirë dhe programet me natyrë profesionale. Ndër instrumentet që përdoren përfshihen takimet me maturantë, përdorimi i rrjeteve sociale, shpërndarja e fletëpalosjeve, organizimit të ditës së universitetit me dyer të hapura, etj.</p> <p>Në takimin me drejtuesit e IAL dhe atë të njësisë kryesore, GVJ u informua në lidhje me politikat e marketingut të ndjekura si dhe mundësitë e zgjerimit të kanaleve të marketingut për të rritur interesin për programet profesionale të studimit, për atë grup studentësh që mund të jenë potencialisht të interesuar për këto programe studimi.</p> <p><i>(Aneks 1.11 Politikat e Marketingut faqe 8)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit me karakter profesional "Agjent i Pasurive të Paluajtshme" (<i>Aneks 3.01, nenet 21-25</i>) si dhe në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore përcaktohet dhe sistemi i njohjes dhe transferueshmërisë së krediteve, ose dhe transferimit të studentëve si dhe vlerësimit të këtyre të fundit. Gjithashtu, në planet mësimore të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo lënde përshkruhen kriteret e vlerësimit dhe përparimit në çdo lëndë. Pedagogët përgjegjës ofrojnë konsultime për studentët në lidhje me çdo paqartësi ose problematikë që mund të impaktojë përparimin akademik të studentëve. Gjithashtu, përmes Portalit të Studentit dhe nëpërmjet postës elektronike, studentët mund të informohen në çdo kohë për çështjet që kanë të bëjnë me përparimin e tyre përgjatë zhvillimit të studimeve</p> <p><i>(Aneks 1.05 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU "Wisdom", neni 8, nenet 24-26)</i></p> <p><i>(Aneks 3.08 Programet mësimore)</i></p>

	(Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”, Neni 19) (Aneks 2.14.1 Portali i Studentit)			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara në Rregullore e KU “Wisdom” (Aneks 1.02, nenet 79-89), Rregulloren e Programit të Studimit (Aneks 3.01, neni 21) dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore (Aneks 1.05, neni 32) si dhe në çdo program lënde (Aneks 3.08)</p> <p>Gjithashtu, informacionet mbi procesin e vlerësimit të dijes mund të merren edhe nga pedagogët e lëndëve përkatëse në fillim të zhvillimit të lëndëve (Aneks 2.13.2 Model/template, Tezë kolokiumi). (Aneks 2.13.3 Model/template, Tezë provimi përfundimtar), si përmes procesit të konsultimeve, ashtu edhe përmes informacioneve që ofrohen në Portalin e Studentit. (Aneks 2.14.1 Portali i Studentit.) Në ndihmë të studentëve janë dhe një seri guidash dhe programesh që janë të aksesueshme online në faqen www.wisdom.edu.al në të cilat përfshihen dhe aspekte që kanë të bëjnë me vlerësimin e studentëve.</p> <p>(Programi i Studimit, Guida e Studentit, Udhëzuesi Didaktik, etj.)</p>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, KU “Wisdom” organizon takime të hapura me maturantë për informimin lidhur me ofertën akademike të KU “Wisdom”, duke përfshirë dhe programet e studimit me karakter profesional si dhe publikon guida, si Guida e studentit. Në bazë të politikave të marketingut të KU “Wisdom” tërheqja e studentëve të rinj synohet përmes disa metodave, që përfshijnë si takimet individuale, ditët e hapura, shfrytëzimin e rrjeteve sociale, shpërndarjen e fletëpalsojeve, etj. (Aneks 1.11 Politikat e Marketingut)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>KU “Wisdom” ka krijuar dhe vënë në funksionim një sistem të mirëfilltë të informimit të studentëve në lidhje me të gjitha aspektet që shoqërojnë zhvillimin e studimeve. Me fillimin e programit të studimit, studentët informohen për përmbajtjen e programit të studimit përmes ditëve të orientimit. Në këtë javë dhe në vijim, studentëve u vihen në dispozicion një sërë dokumentesh që përmbajnë informacion të hollësishëm mbi zhvillimin e aspekteve të ndryshme të programit të studimit. Ndër to përfshihen Guida e Studentit, Udhëzuesi i Karrierës, Udhëzuesi Didaktik për programin “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” (Burimi: https://wisdom.edu.al/guida-e-studentit) si dhe Udhëzuesi i Praktikës. (Aneks 3.10).</p> <p>Gjithashtu, në lidhje me çdo lëndë në mënyrë specifike studentëve u jepen syllabuset e lëndëve përmes Portalit të Studentit si dhe çdo informacion tjetër me natyrë sqaruese lidhur me përmbajtjen e programit të studimit. Si në mjediset e KU “Wisdom”, ashtu edhe përmes kontaktimit me email, Sekretaria Mësimore, konsulentët e Zyrës së Karrierës mund të kontaktohen përmes mënyrave të kontaktit të publikuara përmes faqes së internetit të KU “Wisdom” (https://wisdom.edu.al/sekretaria). Informacione mbi kohëzgjatjen, dhe organizimin e programit dhe komponentët e këtij programi studimi në vija të përgjithshme gjenden edhe në faqen zyrtare të KU “Wisdom” www.wisdom.edu.al</p> <p>(Aneks 1.09 Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Për shkak të natyrës së këtij programi studimi profesional, konstatohet se ka një kuadër rregullator të miratuar dhe funksional në lidhje me informimin e studentëve për zhvillimin e praktikave profesionale. Për këtë qëllim, është miratuar Udhëzuesi i Praktikave (Aneks 3.10), dokument i aksesueshuesm online përmes faqes zyrtare në internet të KU “Wisdom”.</p> <p>Nga takimi i zhvilluar me stafin akademik të angazhuar në mbikqyrjen e praktikave mësimore, por edhe me studentët e këtij programi studimi me karakter profesional, u evidentua se caktimi i praktikës është një proces që zhvillohet në bashkëpunim midis studentëve dhe IAL. Përzgjedhja e agjencisë imobiliare/shoqërisë së ndërtimit/biznesit ku kryen praktikën profesionale</p>

	<p>student/studentja bëhet nga ky/kjo e fundit, bazuar në preferencat e tij/saj përmes kontakteve personale ose përmes mundësisimit të zhvillimit të praktikës në një nga institucionet/shoqëritë/studiot partnere të KU “Wisdom” për këtë qëllim. (<i>Aneks 4.05 Marrëveshjet në nivel Program Studimi me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”</i>.) Gjatë zhvillimit të praktikës, dhe për qëllime të hartimit të raportit përfundimtar të praktikës studentët asistohen nga pedagogët mbikqyrës.</p> <p>Gjithashtu, mundësitë e praktikave dhe mundësitë e punësimit u vihen në dispozicion studentëve përmes “Portalit të Studentit”, faqes zyrtare në internet të KU “Wisdom” në seksionin e njoftimeve, përmes konsultimeve individuale me konsulentin e Karrierës, si dhe përmes panairëve “Work and Study”. (<i>Aneks 1.11 Politikat e marketingut të KU “Wisdom”</i>), (<i>Aneks 4.09 Kërkesa dërguar institucioneve dhe kompanive apo agjensive imobiliare për praktikën mësimore të studentëve të këtij programi studimi</i>). Gjatë vizitës në KU “Wisdom”, GVJ u informua lidhur me takimet e zhvilluara, panairët si dhe trajnimet për ngritjen e kapaciteteve të studentëve për tu përballur me sfidat e tregut të punës në fushën e menaxhimit të pasurive të paluajtshme.</p>
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Përveç informacionit lidhur me mbarëvatjen e procesit mësimor, studentët vihen në dijeni lidhur me logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në dispozicion të tyre, me qëllim përparimin akademik. Konkretisht, në faqen web të KU “Wisdom” krahas informacionit mbi programet e studimit, jepen të dhëna mbi aspektet logjistike të zhvillimit të mësimin, mjediset, bibliotekën, shërbimet e sekretarisë, karrierës, dhe IT, mundësitë e akomodimit në konvikt dhe mjediset çlodhëse. Gjithshtu, këto informacione u jepen studentëve dhe gjatë ditëve të orientimit.</p> <p>(<i>Aneks 2.22 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Të gjitha të dhënat në lidhje me programin e studimit si më sipër u vihen në dispozicion studentëve përmes disa kanaleve të komunikimit, si nëpërmjet strukturave të brendshme të IAL, konkretisht Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, nëpërmjet faqes së internetit të KU “Wisdom” www.wisdom.edu.al si dhe Portalit të Studentit</p>

	i cili është i aksesueshëm në çdo kohë në distancë nga studentët përmes kredencialeve të tyre individuale. (Aneks 2.14.1 Portali i Studentit)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	Struktura përgjegjëse e “KU “Wisdom” qëmban dhe administron të dhënat mbi studentët e regjistruar është Sekretaria Mësimore. Sekretaria Mësimore ruan të dhënat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Deri në momentin e realizimit të vlerësimit të jashtëm të këtij programi studimi me karakter profesional, nuk ka studentë të diplomuar, pasi brezi i parë pritët të diplomohet në vitin akademik 2019-2020. (Aneks 1.05), (Aneks 2.14 Të dhëna Tabelore për programin e studimit me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluajtshme) (Aneks 2.12 Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit të studimit me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluajtshme”.) (Aneks 1.10 Politika institucionale e publikimit të informacionit)
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria Mësimore e KU “Wisdom” realizon procesin e mbajtjes dhe ruajtjes së të dhënave për numrin e studentëve të regjistruar. Në sajë të të dhënave që disponon, Sekretaria Mësimore është në gjendje të raportojë për numrin e studentëve të regjistruar, atyre të larguar, atyre që nuk përfundojnë me sukses vitin akademik dhe atyre të transferuar në përputhje me Rregulloren e Transferimeve Këto të dhëna statistikore pasqyrohen në raportin vjetor të KU “Wisdom

	<p>(Aneks 2.05.3 Raport vjetor i KU "Wisdom" VA 2018-2019 Nr. 28 prot, datë 23.10.2019)</p> <p>(Aneks 2.14 Të dhëna tabelore për programin e studimit me karakter profesional "Agjent i pasurive të paluajtshme), (Aneks 2.12 Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit të studimit me karakter profesional "Agjent i pasurive të paluajtshme)</p> <p>(Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes)</p> <p>(Aneksi 2.07 Rregullorja e transferimeve).</p> <p>(Aneks 1.05 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU "Wisdom")</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Sekretaria Mësimore e KU "Wisdom" mban informacion mbi ecurinë e studentëve, në lidhje me rezultatet e procesit të vlerësimit të dijes që prej fillimit të programit të studimit si dhe i arkivon këto të dhëna në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe atë për arkivat.</p> <p>Nga ana tjetër, Zyra e Karrierës, është në gjendje të mbledhë informacion mbi alumni-t dhe punësimin e tyre eventual pas diplomimit. Konsulentët e zyrës mbajnë kontakte me studentët e diplomuar me qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të programit të studimit si dhe forcimin e partneriteteve me aktorë të ndryshëm të tregut të punës. Bazuar në këtë plan. datë 29 qershor 2020 është realizuar një takim në platformën Zoom me alumni të KU "Wisdom".</p> <p>(Aneks 2.20 Plani i punës së zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe jetës studentore.)</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat e studentëve mbahen dhe administrohen nga Sekretaria Mësimore si në <i>hard copy</i>, ashtu edhe në formë elektronike. Ato bëhen të aksesueshme nga studentët dhe stafi përmes Portalit të Studentit.</p> <p>(Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes, Neni 114 Sekretaria Mësimore)</p> <p>Këto të dhëna bëhen të aksesueshme në përputhje me politikat e publikimit të informacionit të KU "Wisdom" bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik. Gjatë vizitës në KU "Wisdom", GVJ pati mundësi të inspektonte disa nga regjistrat dhe procesverbalet ku mbahen të dhëna për studentët.</p>

	<i>(Aneks 1.10 Politika institucionale e publikimit të informacionit)</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Për sa iu përket cilësisë në hyrje të studentëve në këtë program studimi nuk rezulton të jetë hartuar një raport analitik në lidhje me studentët e pranuar, si dhe me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi.</p> <p>Në lidhje me cilësinë në dalje ende nuk është hartuar një raport për shkak se brezi i parë i të diplomuarëve për këtë program studimi është në vitin akademik 2019-2020. Të dhënat e këtij raporti do të duhet të pasqyrohen më pas në analizën vjetore të strukturave përkatëse të KU “Wisdom” me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Aneks 2.05.3 Raport vjetor i KU “Wisdom” VA 2018-2019 Nr. 28 prot, datë 23.10.2019).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Në përputhje me kërkesat e nenit 99 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucione të arsimit të lartë në RSH”, kuadri rregullator për funksionimin e KU “Wisdom” parashikon në mënyrë eksplicite përfshirjen aktive të studentëve dhe përfaqësuesëve të tyre në organet vendimmarrëse të KU “Wisdom”. Bazuar në Statutin e KU “Wisdom” studentët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Këshillin e Studentëve çdo dy vjet dhe përmes këtij të fundit përfaqësuesit në Senat Akademik si dhe në struktura të tjera të universitetit si në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore, Karrierës, dhe Jetës Studentore ndërmerr masa për informimin e studentëve lidhur me zhvillimin e këtij procesi përzgjedhës përmes konsulentëve të Zyrës, si edhe faqes zyrtare të KU “Wisdom” në web.</p>

	<p>(Aneks 2.20 Plani i punës së Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, fq. 6)</p> <p>(Aneks 2.20.1 Procesverbal “Për zgjedhjen e studentëve/senator sipas grupeve”)</p> <p>(Aneks 1.01 Statuti i KU “Wisdom”, Neni 73)</p> <p>(Aneks 2.03 Vendim I Rektorit të KU “Wisdom” Për miratimin e GVB)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Procesi ipërzgjedhjes së përfaqësuesëve të studentëve në Këshillin Studentor është i dokumentuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore (Aneks 2.20.1 Procesverbal “Për zgjedhjen e studentëve/senator sipas grupeve”, Nr. 54 prot, datë 07.11.2019) në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 99, (Aneks 1.01 Statuti i KU “Wisdom”, Neni 14 dhe 73)</p> <p>Nga dokumentacioni i dorëzuar për efekt të akreditimit të këtij programi studimi rezulton se specialistja e Zyrës së Karrierës ka marrë pjesë në disa nga mbledhjet e Këshillit Studentor, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së anëtarëve të Këshillit në proceset vendimmarrëse në KU “Wisdom” si dhe informimin e studentëve lidhur me këto procese. (Aneks 2.05.03 Raporti Vjetor i KU “Wisdom” 2018-2019 Nr. 28 Prot. 23.10.2019)</p> <p>Në takimet me studentët e këtij programi studimi, dhe studenten pjesëmarrëse në GVB nuk u konstatuan problematika lidhur me nivelin e pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje ose këshillim në KU “Wisdom”.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit mbetet përgjegjësi e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, konkretisht, Departamentit të së Drejtës Private. (Aneks 2.06 Rregullore e Departamentit të së drejtës Private, Neni 8, Funkcionet e Departamentit.)</p> <p>Ky program studimi ka një ngarkesë akademike prej 4 semestrash, me 120 kredite në total. (Aneks 3.03 Plani mësimor). Gjatë vizitës në KU “Wisdom”, GVJ pati mundësi të merrte informacion lidhur me vlerësimin e studentëve për këtë program studimi. Ata nuk paraqitën rezerva lidhur me ngarkesën e programit të studimit dhe u shprehën se kurrikula përmban lëndë të cilat janë të disiplinave të ndryshme dhe të dobishme për programin e</p>

	studimit me karakter profesional “Agjenti i Pasurive të Paluajtshme”.			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	<p>Angazhimi i studentëve në përmirësimin e programit të studimit realizohet përmes marrjes së mendimeve dhe sugjerimeve nga pyetësi i studentit. (<i>Aneks 2.15.4 Model/Template, pyetësi i studentit</i>) si dhe përmes procesit të konsultimit pedagog-student.</p> <p>Nuk ka të dhëna që të vërtetojnë nëse në periudhën dy vjeçare të zhvillimit të këtij programi studimi, janë reflektuar sugjerimet e studentëve në përmirësimin e këtij programi, nga njëri vit në tjetrin.</p>			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Në përputhje me parashikimet e disa akteve rregullatore të miratuara nga KU “Wisdom” studentët kanë mundësi të ankimojnë vlerësimin e bërë nga pedagogët gjatë procesit të kontrollit të dijes. Gjithashtu, opinionet dhe sugjerimet e tyre mund ti shprehin përmes vlerësimit që zhvillohet në përfundim të çdo lënde, përmes një sistemi të anonimizuar.</p> <p>(<i>Aneks 2.15.4 Model/Template, pyetësi i studentit</i>)</p> <p>(<i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes, Neni 89, Ankimimi i studentëve</i>)</p> <p>(<i>Aneks 2.06 Rregullore e Departmanetit të së Drejtës Private, neni 25</i>)</p> <p>(<i>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimit me Karakter Profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme</i>)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Në strukturën organike të KU “Wisdom” janë ngritur njësi të posaçme për informimin e studentëve. Në to përfshihen: Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, Koordinatorit të Programit të Studimit, Zyra e IT-së, dhe Sekretaria Mësimore.

	<p>Më konkretisht, Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është përgjegjëse për informimin dhe ofrimin e asistencës ndaj studentëve në lidhje me aspekte të ndryshme të zhvillimit të veprimtarisë kurrikulare dhe ekstrakurrikulare. Kjo Zyrë mundëson ofrimin e informacioneve të natyrave të ndryshme që prej nisjes së studimeve, përmes ditëve të orientimit, dhe deri në përfundimin e studimeve, përmes shërbimeve të këshillimit të karrierës. Një tjetër burim shumë i rëndësishëm informacioni për studentët është Portali i Studentit, në të cilin ngarkohen informacione të nevojshme si nga pedagogët ashtu edhe nga stafi administrativ, me qëllim informimin e studentëve. Ky portal mirëmbahet dhe administrohet nga Zyra e IT në përputhje me udhëzuesin e monitorimit të strukturës së teknologjisë së informacionit. Sekretaria Mësimore është një tjetër strukturë e cila mbart përgjegjësinë për të informuar studentët lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në KU “Wisdom”. Në Rregulloren e Programit të studimit parashikohen edhe procedura të tjera për informimin dhe këshillimin e studentëve, si nëpërmjet konsultimeve nga pedagogët, kryesisht në lidhje me format dhe kriteret e kontrollit të dijeve. Informacionet e përgjithshme për studentët bëhen publike edhe përmes faqes në internet të KU “Wisdom”</p> <p><i>(Aneks 1.06 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, Neni 6, pika 13-25);</i></p> <p><i>(Aneks 2.20 Plani i punës së zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore);</i></p> <p><i>(Aneks 1.08 Udhëzues për monitorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit);</i></p> <p><i>(Aneks 1.05 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU “Wisdom”, Neni 2)</i></p> <p><i>(Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme”, Neni 19.)</i></p> <p><i>(Aneks 1.09 Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it) në përputhje me politikat institucionale të publikimit të informacionit</i></p> <p><i>(Aneks 1.10)</i></p>
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem</p>	<p>Përmes strukturave dhe procedurave në shërbim të përparimit të studentëve të cituara në seksionin e Kriterit 1</p>

<p>i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>të këtij Standardi vlerësimi, KU “Wisdom ka mundësuar ofrimin e një sistemi të plotë orientimi, informimi të studentëve dhe ndjekjen e përparimit të tyre në përputhje me objektivat e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Aneks 2.20 Plani i punës së zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës studentore)</i></p> <p><i>(Aneks 2.14.1 Portali i Studentit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore e KU “Wisdom” ka detyrë funksionale që përmes specialistëve të saj të organizojë të gjithë procesin e mbështetjes së studentëve që nga organizimi i ditëve orientuese, vënien në dispozicion të të gjitha të dhënave dhe informacioneve të vlefshme lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, deri tek këshillimi i karrierës. Nga takimi me specialisten e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Karrierës dhe Jetës Studentore GVJ u informua lidhur me zhvillimin e veprimtarive të planifikuara me studentët e rinj, me ata që vazhdojnë studimet për qëllime të zhvillimit të aftësive të tyre për t’u përballur me kërkesat e tregut të punës përmes asistencës në hartimin e CV ose profileve në rrjete sociale profesionale si linkedIN, si dhe me këshillimin për mundësitë e zhvillimit të praktikave dhe punësimin në të ardhmen.</p> <p><i>(Aneks 1.06 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, Neni 6, pika 13-25)</i></p> <p><i>(Aneks 2.20 Plani i punës së zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.)</i></p> <p><i>(Aneks 4.01.1 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit)</i></p> <p><i>(Aneks 4.05 Marrëveshjet në nivel Program Studimi me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluajtshme”)</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore e KU “Wisdom” funksionon në bazë të Rregullores së kësaj Zyre, dhe krahas funksioneve të tjera, ka si detyrë gjurmimin si dhe ruajtjen e të dhënave për studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucione e arsimit të lartë në RSH”, neni 32. Në planin e punës së kësaj zyre përcaktohet me hollësi mënyra e ruajtjes dhe përthithjes së informacionit nga alumnit. Konkretisht, në planin e punës</p>

	<p>parashikohet se Zyra e Karrierës, përmes specialistit të kësaj Zyre, kontakton studentët e diplomuar për të marrë informacion mbi punësimin e tyre. Në planin e punës synohet dhe realizimi i një takimi me ish studentë të KU “Wisdom” për të ndarë përvojat në përballjen me tregun e punës dhe për marrjen e feedback-ut për përmirësimin e kurrikulave. Takimet me alumni të zhvilluara deri në vitin akademik 2019-2020 u referohen të diplomuarëve të programeve të tjera të studimit, pasi për këtë program studimi brezi i parë i të diplomuarëve përfundon studimet në vitin akademik 2019-2020.</p> <p><i>(Aneks 1.06 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore)</i></p> <p><i>Aneks 2.20 Plani i punës së zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe jetës studentore)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në: “Agjent i Pasurive të Paluatshme”

a. Pika të forta dhe afirmime:


1. Kuadri rregullator i miratuar nga KU “Wisdom” në funksion të programit të studimit “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” është i plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
2. Ky program studimi realizohet në sajë të një bashkëpunimi të frytshëm midis njësive përbërëse të KU “Wisdom, stafit akademik dhe administrativ, në funksion të optimizimit të ofrimit të këtij programi studimi;
3. KU “Wisdom” ofron një program profesional që nuk ofrohet nga asnjë IAL tjetër në vend. Ky program studimi përputhet me misionin dhe qëllimin e KU “Wisdom”, por edhe me nevojat e tregut të punës për agjentë të pasurive të paluajtshme, bazuar në studimet e tregut të zhvilluara nga KU “Wisdom”;
4. Programi i studimit është hartuar mbi bazën e një qasjeje ndërdisiplinore, ku studentëve u ofrohen njohuri të natyrës juridike, ekonomike, të shkencave të komunikimit si dhe në

fushën e ndërtimit. Programi i studimit me karakter profesional “Agjent i pasurive të paluatshme”, është i paraqitur i plotë dhe me objektiva dhe veprimtari formuese të përcaktuara qartë;

5. Përgjatë dy viteve të zhvillimit të këtij programi studimi, KU “Wisdom” ka zhvilluar disa trajnime për studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi në lidhje me aspekte të veçanta që kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive komunikative, vlerësimin e pronës, manaxhimin, marketingun në fushën e pasurive të paluajtshme, etj;
6. Marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura nga KU “Wisdom” dhe partnerë në fushën e pasurive të paluajtshme përmbajnë klauzola konkrete mbi format e bashkëpunimit, mënyrat e shkëmbimit të përvojave, dhe mundësimin e zhvillimit të praktikës mësimore dhe punësimit të studentëve;
7. KU “Wisdom” ka krijuar dhe ka vënë në funksionim një sistem të mirëfilltë të mbështetjes së studentëve të përbërë nga njësi përgjegjëse dhe procedura që synojnë mbarëvajtjen e studimeve për çdo student dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës përmes këshillimit të karrierës;
8. “Portali i Studentit” është një platformë online funksionale e ngritur nga KU “Wisdom” për qëllime të mbarëvajtjes së procesit të studimeve. Përmes saj realizohet shkëmbimi i informacionit midis studentëve, pedagogëve dhe stafit administrativ. KU “Wisdom” ka ofruar në vijimësi mbështetje teknike ndaj studentëve dhe stafit akademik për të lehtësuar aksesin në këtë portal si dhe për të facilituar zhvillimin e mësimin përmes metodave të e-learning;
9. Infrastruktura e vënë në dispozicion të këtij programi studimi konsiderohet optimale si për studentët ashtu edhe për stafin akademik dhe atë administrativ të angazhuar në këtë program studimi;

b. Pika të dobëta:

1. Në këtë program studimi nuk realizohet një raport i balancuar midis lëndëve të natyrës praktike dhe teorike, si dhe nuk i akordohet pesha e duhur praktikës profesionale në përputhje me standardet e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe VKM nr. 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019;
2. Pavarësisht se në pjesën më të madhe të lëndëve literatura bazë është ofruar në gjuhën shqipe, ka disa lëndë ku literatura bazë është në gjuhën angleze. Literatura ndihmëse për një pjesë të madhe të programeve të studimit është gjithashtu në gjuhën angleze. Shfrytëzimin e të gjithë materialeve të kursit, kërkon që studentët të kenë një nivel të lartë njohurish në gjuhën angleze. Gjuha e huaj është lëndë me zgjedhje në këtë program studimi;
3. Programi i studimit përmban disa module (si për shembull “E drejtë biznesi”, “Mikroekonomi” dhe “Makroekonomi”) që janë njëlloj si në programet e ciklit bachelor, duke rritur informacion teorik që studentët e këtij kursi marrin dhe, ndikuar negativisht në raportin teori – praktikë;




4. Plani mësimor nuk përmban mjaftueshëm module/lëndë/tema në lidhje në fushën e marketingut digjital, me qëllim përgatitjen sa më të mirë të studentëve me tregun e punës dhe shitjen në epokën digjitale.

Rekomandime:

1. Në faqen zyrtare në internet e KU “Wisdom” në seksionin e dedikuar programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” nuk përmban informacion tjetër përveç planit mësimor. Në të nuk janë përfshirë të dhëna sqaruese në lidhje me organizimin e këtij program studimi si dhe rregulloren përkatëse të tij, të cilat rekomandojmë të plotësohen;
2. Të rritet pesha e praktikës në vitin e parë të studimit, duke rishikuar programin mësimor të lëndëve bazë që zënë 26.6% të programit të studimit ose 32 ECTS dhe zhvillohen pothuajse të gjitha në vitin e parë;
3. Disa module që janë njëlloj si në programet e ciklit bachelor (si për shembull “E drejtë biznesi”, “Mikroekonomi” dhe “Makroekonomi”), mund të konsiderohet të riformatohen, të thjeshtohen për t’ju përshtatur më mirë nevojave të këtij programi studimi;
4. Për një orientim teorik dhe praktik më të ngushtë në lidhje me tregun e pasurive të paluajtshme, do të rekomandonim që lënda “Legjislacioni mbi tatimet dhe taksat”, mund të fokusohet në legjislacionin mbi tatim taksat që lidhet me pasuritë e paluajtshme, konkretisht më shumë me aspekte të taksimit të pasurive të paluajtshme, se sa të procedurave tatimore. Lënda “Parimet themelore të finances” dhe “menaxhimi financiar”, mund të fokusohet në financimin e pasurive të paluajtshme, si dhe lënda “Ekonomi ambjenti”, mund të fokusohet në ndërtimin dhe probleme që lidhen me impaktin mjedisor të ndërtimeve;
5. Të konsiderohet që të ofrohen si lëndë të detyrueshme dhe jo si lëndë më zgjedhje lëndët “Informatikë civile dhe tregtare” dhe “Gjuha e Huaj”, bazuar në rëndësinë që ka marketingu digjital për këtë profesion dhe gjuha e huaj për shfrytëzimin e të gjithë materialeve të kursit;
6. Pavarësisht se procedurat e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në disa nga rregulloret që normojnë zhvillimin e këtij programi studimi me karakter profesional, mungon një rregullore e posaçme për kriteret dhe procedurën e vlerësimit të studentëve në përputhje me kërkesat e Standardit III.4 Kriteri 1;

**Conclusions of the Evaluation of the study program with professional character in:
“Immovable property agent”**


a) Strength and affirmations:



1. Regulatory framework approved by “Wisdom” University College for the study program “Real Estate Agent” is complete, according to the legal framework for high education in Albania and provides the well-functioning of this study program;
2. This program is realized with collaborations between different units of “Wisdom” University College, such as academic staff and administrative staff, in order to offer a high quality study program;
3. “Wisdom” University College, offers a professional program in “Real Estate Agent”, that is not offered by another high education institution in Albania. This study program is not only in accordance with the mission of “Wisdom” University College, but also with the needs of labor market for real estate agents, based on the market study for this profession organized by “Wisdom” University College;
4. This study program is interdisciplinary and offer knowledge in law, economics, communication science and constructions. The study program is complete with goals and teaching methods are well defined;
5. During the years that this program is implemented, “Wisdom” University College has organized training for the stuff and for the students of this study program. The focus of training was the development of communication abilities, real estate evaluation, management and marketing of real estate, etc.;
6. The collaboration agreements that “Wisdom” University College have signed with real estate companies and investment companies, are well defined with concrete collaboration manner for exchange of the experiences and the possibility for practical working hours and employment of the students;
7. “Wisdom” University College has created and implemented a system that support the students, with responsible units and procedures, that aim following the academic performance of each student and prepare them for the labor market requirements;
8. “The student portal” is online functional platform implemented by “Wisdom” University College for the purpose of well-functioning of the study process. Through this platform is realized the exchange of information between the students, academic staff and administrative staff. “Wisdom” University College offers technical support for the students and academic staff, in order to facilitate the teaching process through e –learning process;
9. The infrastructure for this study program is optimal for the students, academic stuff and administrative stuff.

b) Weaknesses:

1. This study program has not a balance between practical working hours and theoretical academic hours in the syllabus, and the professional practic has the specific weight in the program that is not in accordance with the approved “Quality Code for the Higher Education” and VKM no. 41, date 24.01.2018, changed with VKM no. 879 date 18.12.2019;
2. Even though the base literature is mainly in native language, there are some modules that have the base literature in English. Additional literature for quite all the study programs is also in English language. This requires very good English knowledge from the students of




this course, in order to use all the teaching materials. Foreign language is not an obligatory subject for this study program;

3. The study program has some syllabuses that are the same as in the bachelor program (such as “Business Right”, “Macroeconomics” and “Microeconomics”). These increase the theoretical working hours to the students of this course and affect negatively to the balance between theoretical academic working hours versus practical working hours;
4. The teaching program does not have enough modules/subjects related to the field of digital marketing, that are necessary for preparation of the student according to the requirement of labor market in the digital area that we live;

Recommendation:

1. In the official website of “Wisdom” University College in the section dedicated to this study program, have only the teaching program. In the website are not included other relevant information such as organization and regulation of this study program. We recommend to include other important information for this study program;
2. Especially for the first year of the study, we recommend to increase practical working hours versus theoretical academics hours. By revising the teaching program for the base modules that account for about 26.6% of the study program or 32 ECTS, and are mainly in the first year of the study;
3. For the modules that are the same as in bachelor program (such as “Business Right”, “Macroeconomics” and “Microeconomics”), we recommend to revise the syllabus, in order to make them easier in order to better fit the requirement of this professional study program;
4. In order to increase the practical working hours in this study program and to have a better orientation to the labor market, we recommend that the module “Tax Legislation”, could be focused more on tax legislation for real estate and not in tax procedures. The module “Introduction to Finance and Management”, could be focused more on the ways that real estate properties are financed. The module “Environmental Economics”, could be focused more on construction and the problems that are related to environmental impact of the constructions;
5. We recommend that courses such as “Civil and Commercial Informatics” and “Foreign Language” to be obligatory, based on the importance of digital marketing for this profession and knowledge of foreign language (English) for using all the teaching material of the course;
6. Even though the student evaluation procedure is well defined, in some regulation of this professional study program, there is not well specified the criterion and the procedure of student evaluation according to Standard III.4 1 Criterion 1;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Elida Liko

Dr. Adea Pirdeni Mjur (Oxon)